

MONITORIMI I PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT

Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike 2020-2030

Të gjitha të drejtat në këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

JANAR 2022



Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri
www.recshqiperi.org

PËRMBAJTJA

SHKURTIMET	4
I. PËRMBLEDHJE E KUADRIT KONCEPTUAL TË PROCESIT TË PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT	6
II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT	8
III. NJOHJE ME UDHËZIMET TEKNIKE PËR PLANIN KOMBËTAR TË VEPRIMIT.....	10
IV. MONITORIMI I ZBATIMIT TË MASAVE SIPAS SEKTORËVE	12
4.1 Vlerësimi i përgjithshëm	12
4.2 Vlerësimi i masave për sektorin e mjedisit	15
4.3 Vlerësimi i masave për sektorin e turizmit.....	23
4.4 Vlerësimi i masave për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural	23
4.5 Vlerësimi i masave për sektorin e menaxhimit të ujërave	29
4.6 Vlerësimi i masave për territorin, infrastrukturën dhe energjinë	32
4.7 Vlerësimi i masave për shëndetësinë	33
4.8 Vlerësimi i masave në nivelin vendor	34
V. GJETJE KRYESORE	37
VI. ZBATUESHMËRIA E VEPRIMEVE PRIORITARE (VP), NË METRIKËN E NGJYRAVE.....	40
VII. BURIMET	42

SHKURTIMET

ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKP	Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
CCAWB	Projekti i Ballkanit Perëndimor
CO ₂	Dioksid karboni
DKU	Direktiva Kuadër e Ujit
DSHP	Drejtoria e Shëndetit Publik
EbA	Përshtatja e Bazuar në Ekosistemin
EFAS	Sistemi Evropian i Ndërgjegjesimit për përmbytjet
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
EUCPM	Mekanizmi i BE për Mbrojtjen Civile
FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
GCF	Fondi i Gjellbër për Klimën
GEF	Fondi Global i Mjedisit
GES	Gazet me Efekt Serrë
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GNPNK	Grupi Ndërmintor i Punës për Ndryshimet Klimatike
HEC	Hidrocentrale
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
IGJEO	Instituti i Gjeoshkencave
IISD	Instituti Ndërkombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm
IKMT	Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit
IPA	Kuadri i Instrumentit Ndihmës për Para-anëtarësim
IPARD II	Kuadri i Instrumentit Ndihmës për Para-anëtarësim i Zhvillimit Rural
IRGJB	Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KK	Kontributi Kombëtar
KKDM	Komiteti Kombëtar të Digave të Mëdha
KKP	Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar
KKPNK	Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar ndaj Ndryshimeve Klimatike
KKKBNK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
M&V	Sistemin e Monitorimit dhe të Vlerësimit
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
MIBU	Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTE	Ministria e Transportit dhe Energjetikës
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NK	Ndryshimet Klimatike
OJF	Organizata Jofitimprurëse
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PBA	Procesi Buxhetor Afatmesëm
PBUU	Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes
PKEC	Planit Kombëtar për Emergjencat Civile
PKP	Plani Kombëtar i Përshtatjes
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PMBL	Plani i Menaxhimit të Basenit Lumor
PMBU	Plani për Menaxhimin e Baseneve Ujore
PNUD	Programi i OKB-së për Zhvillim
REC Shqipëri	Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri
RGJB	Resurset Gjenetike Bimore

RGJBUB	Resurset Gjenetike të Bimëve për Ushqimin dhe Bujqësinë
SCCF	Fondi Special i Ndryshimeve Klimatike
Sida	Agjencia Suedeze për Zhvillim të Bashkëpunimit Ndërkombëtar
SK	Strategjia e Klimës
SKNK	Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SLKV	Sistemi i Lagunës Kune – Vain
SNAP	Inventarizimi i Planit Kombëtar të Përshtatjes
sHPP	Hidrocentrale të Vogla
TVSH	Taksa mbi vlerën e shtuar
UNDP	Programi i OKB-së për Zhvillim
UNEP	Programi i OKB-së për Mjedisin
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
WFD	Fondacioni Westminster për Demokraci
ZABU	Zyra e Administrimit të Baseneve Ujore

I. PËRMBLEDHJE E KUADRIT KONCEPTUAL TË PROCESIT TË PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT

Kuadri i Veprimeve Prioritare për Ndryshimet Klimatike, që është pjesë e integruar e Strategjisë Kombëtare, është bazuar thuajse tërësisht në një dokument me titull “Plani Kombëtar i Përshtatjes për Shqipërinë, PKP” (*Anglisht*: National Adaptation Plan, NAP).

Hartimi i Planit Kombëtar të Përshtatjes për Shqipërinë, ishte një proces që zgjati dy vite, nga viti 2016 deri në vitin 2018. Puna për zhvillimin e këtij dokumenti u mbështet në asistencën e PlanAdapt, i cili në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) të Shqipërisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Grupin Ndërmnistror të Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK), si dhe në bashkëpunim me Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), udhëhoqi procesin. PlanAdapt është një ekip ndërdisiplinor specialistësh të angazhuar në çështjet e qëndrueshmërisë dhe rreziqeve ndaj klimës, me përfaqësues nga gjithë bota. Mbështetja fillestare përfshinte zhvillimin e një strategjie financimi për Planin Kombëtar të Përshtatjes, që synonte ofrimin e udhëzimeve mbi mënyrat e financimit të aktiviteteve të përshtatjes me ndryshimet klimatike në vitet e ardhshme.

Pjesë e këtij plani ishin dhe strategjitë e propozuara lidhur me procesin e identifikimit të pikave hyrëse në financimin ndërkombëtar për klimën, si dhe një përmbledhje e përditësuar e mundësive të financimit me burimet kombëtare dhe ndërkombëtare, publike dhe private të veprimtarisë përshtatëse. Plani propozonte metodat e identifikimit dhe renditjes së projekteve dhe programeve, sipas gatishmërisë së tyre për të financuar përshtatjen. PlanAdapt, gjithashtu inicioi zhvillimin e një udhërrëfyese që do të lehtësonte integrimin e planifikimit të përshtatjes në proceset e rregullta buxhetore nëpër ministri të ndryshme.

Në vitin 2017, PlanAdapt punoi me Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) për të zhvilluar kriteret dhe tregues të lidhur me përshtatjen, për shqyrtimin, përzgjedhjen dhe monitorimin e projekteve të FSHZH-së në infrastrukturë. Mbështetja u ofrua në kuadër të Rrjetit Global për Planin Kombëtar për Përshtatjen (PKP) ndaj Ndryshimeve Klimatike, e koordinuar nga Sekretariati i Rrjetit me bazë në Institutin Ndërkombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm (IISD). Si rezultat i këtij projekti u zhvilluan 'Udhëzimet për të integruar reagimin ndaj klimës në procedurat e FSHZH'. Synimi ishte harmonizimi i planifikimit të infrastrukturës së Shqipërisë me rregulloret e BE-së, në këtë fushë në të ardhmen dhe shqyrtimi i projekteve të infrastrukturës duke marrë në konsideratë rreziqet klimatike, ku është e mundur.

Plani Kombëtar i Veprimit, PKV për Shqipërinë është konceptuar si proces afat-gjatë dhe ndër-sektorial. Ai konsiderohet dhe njihet si Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP), i cili u njoftua zyrtarisht nga Zv/Ministri i Turizmit dhe Mjedisit në shkurt 2015. Është mbështetur nga GIZ në kuadër të Projektit të Ballkanit Perëndimor (CCA WB) dhe në konsultim të ngushtë me Programin e OKB-së për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkimin Evropian (BE). Gjatë vitit 2015 dhe 2016, ministrinë përkatëse të linjës¹ kanë bashkëpunuar ngushtë nën drejtimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe GNPNK (Grupi Ndërmnistror për NK) për të kontribuar në zhvillimin e Dokumentit të PKV.

Procesi i hartimit të PKV për Shqipërinë është bazuar në kontributin e grupit teknik të ekspertëve të institucioneve përgjegjëse për çështjet e klimës. Procesi i monitorimit me anë

¹ Në atë periudhë janë përfshirë Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

të intervistave të gjysëm strukturuara evidentoi përmes reflektimit të pjesëmarrësve në procesin e hartimit të PKV disa çështje që mund të kenë ndikuar në masat e propozuara dhe prioritarizimin e tyre.

- 🗨️ Pjesëmarrja dhe kontributi prej përfaqësuesve të ministrive përkatëse të linjës gjatë procesit ka qenë jo e balancuar. Ky fakt mund të ketë sjellë edhe një përfaqësim jo të shpërndarë drejt masave sipas nevojave të identifikuara në secilin sektor.
- 🗨️ Shkalla e njohjes rreth tipologjisë së masave përshtatëse ka qenë e ulët, për shkak të informacionit ende të kufizuar global dhe kombëtar mbi efektet e ndikimit të ndryshimeve klimatike. Ndikimi në sektorë specifike është bazuar më shumë në reflektime dhe të dhëna të pjesshme dhe jo në studime dhe njohje të thelluar. Ky fakt mund të ketë sjellë propozimin e masave të përgjithshme, të cilave mund t'u mungojnë objektivat për rezultate konkrete apo rajonet gjeografike ku ndikimi i ndryshimeve klimatike është më i shprehur.

Krijimi i GNPKNK-së, u pa si angazhim nga ana e autoriteteve publike për të rritur njohjen ndaj rreziqeve të lidhura me ndryshimet klimatike dhe nevojën për të vepruar. Gjatë kësaj periudhe grupi i punës i ekspertëve shqyrtoi kuadrin ekzistues institucional dhe identifikoi boshllëqet dhe nevojat përmes përdorimit të Mjetit të Inventarizimit të Planit Kombëtar të Përshtatjes (SNAP), si në vijim: koordinim i mangët dhe i pamjaftueshëm mes sektorëve, si dhe mungesë të strukturave të konsoliduara për klimën në institucione. Procesi identifikoi edhe mundësi si p.sh potenciale në integrimin e përshtatjes ndaj klimës dhe përfitime të mundshme nga fondet për klimën në kuadër të PKP. PKP u njoftua në qershor 2016, në asamblenë e PKP që u organizua në bashkëpunim me Rrjetin Global të PKP.

Pas miratimit të Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike në vitin 2019, nuk ka pasur asnjë proces vlerësimi apo ndryshimi të PKP. Rishikimi për qëllime përmirësimi apo ndryshimi të masave është vlerësuar si nevojë në vazhdimësi, duke u përfshirë në planet e institucioneve qendrore përgjegjëse (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit) dhe të agjencive të mbështetjes së huaj. Si rezultatet i kësaj punë, është parashikuar hartimi i PKP, në kuadër të një projekti të ri, i cili ka filluar zbatimin në vitin 2021 nga PNUD. Veprimtaritë e lidhura me hartimin e PKP-së si diskutimi i masave prioritare në sektorët strategjikë dhe disa çështje ndër sektoriale të lidhura më to, janë planifikuar për tu realizuar gjatë vitit 2022.

II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Ky raport është dokumenti i dytë monitorues në kuadër të procesit të monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike, SKNK të nisur gjatë vitit 2021², në fazën e parë të së cilit u monitoruan zhvillimet ligjore, mbështetja financiare dhe ndërtimi i kapaciteteve për çështjet e klimës. Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit (PKV) synon të vlerësojë shkallën e zbatimit të masave ndërhyrëse dhe ndihmojë planifikuesit dhe vendimmarrësit në shqyrtimin dhe prioritarizimin e ndërhyrjeve prioritare për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike.

Ky raport i dytë monitorues mbulon periudhën tre vjeçare, 2019 – 2021, prej miratimit të SKNK-së deri në fund të vitit 2021. Ai ka marrë në shqyrtim masat prioritare të Planit Kombëtar të Veprimit, sipas sektorëve të ndryshëm bazuar në institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre të tilla si: sektorët e mjedisit, infrastrukturës dhe energjetikës, bujqësisë, shëndetësisë, etj. Për të lehtësuar dhe strukturuar grumbullimin e informacionit me të dhëna konkrete, grupi i ekspertëve ka hartuar një seri pyetjesh vlerësuese, specifike për secilën masë, të cilat gjenden të renditura sipas sektorëve në kapitullin IV “Monitorimi i zbatimit të masave sipas sektorëve”. Këto pyetje kanë shërbyer si udhërrëfyese për grumbullimin e të dhënave dhe vlerësimit të ecurisë prej zyrtarëve të intervistuar. Në rastet kur ky proces ka qenë i pamundur prej mungesës së një personi përgjegjës, pyetjet kanë shërbyer si hipoteza kërkimi dhe vlerësimi për grumbullimin e informacioneve përmes shqyrtimit të botimeve, raporteve të ecurisë, të medias dhe aktorëve të tjerë si organizata të shoqërisë civile.

Procesi i grumbullimit të informacionit është shtrirë në periudhën tetor 2021 – dhjetor 2021, përmes intervistave të gjysmë strukturuara me përfaqësues të institucioneve qendrore, agjencive zbatuese dhe programeve të asistencës së huaj për Shqipërinë (Shtojca 1: Lista e Institucioneve të përfshira në procesin e monitorimit). Përzgjedhja e institucioneve të përfshira në këtë fazë të monitorimit është bazuar në përcaktimet e dhëna në PKV për institucionet përgjegjëse. Intervistimi me qëllim grumbullimin e informacionit dhe sigurimin e të dhënave të vlerësimit është kryer me personat e ngarkuar për çështjet e klimës ose të drejtorive/sektorëve përkatëse përgjegjës për një masë specifike në strukturën e një institucioni, si përsëmbull atë të një ministrie apo agjencie. Gjatë këtij procesi është mbledhur informacion i përbërë kryesisht nga të dhëna cilësore mbi ecurinë e zbatimit, suksesin e ngritjes së fondeve, aktorët e përfshirë, burime të mundshme informacioni për shumën e fondeve të dedikuara dhe të realizuara, rezultatet e arritura nga veprimet e kryera, si dhe nevojat për rishikimin e masave në të ardhmen. Informacioni me të dhënat sasiore është siguruar përmes komunikimit institucional me institucionet përgjegjëse për zbatimin e strategjisë, faqeve të internetit të agjencive dhe programeve specifike, dhe burimet zyrtare të informacionit.

Në kuadër të Marrëveshjes së Parisit, vendi ynë ka hartuar dhe paraqitur Raportin e Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar (KKP) në vitin 2016. Detyrimet në kuadër të kësaj marrëveshjeje kërkojnë rishikimin e objektivave për uljen e shkarkimeve çdo pesë vjet. Rishikimi dhe paraqitja e raportit të dytë të KKP-së për Shqipërinë gjatë vitit 2021, përcaktoi edhe objektivat e reja për uljen e shkarkimeve dhe marrjen e masave zbutëse ndaj ndryshimeve klimatike deri në vitin 2030 në masën 20.9% krahasuar me vitin 2016. KKP përmban në vetvete planin e masave për të ulur shkarkimet e gazeve serë sipas sektorëve.

² <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/monitoring-climate-change-strategy-albania>

Për herë të parë, janë përfshirë edhe masat përshtatëse në sektorin e bujqësisë, blegtorisë, peshkimit, pyjeve dhe ekosistemeve natyrore. Për këtë arsye, rishikimi i KKP-së mund të konsiderohet edhe si një proces reflektues mbi progresin në zbatimin e PKV.

Ngjashëm me procesin e Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike të zhvilluar gjatë muajve të verës së vitit 2021, edhe në këtë proces vlerësimi, sigurimi i të dhënave dhe informacionit ishte një sfidë e vështirë.

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2021 janë drejtuar 5 kërkesa për informacion institucioneve shtetërore mbi ecurinë e zbatimit të masave dhe takime, për të cilat është marrë përgjigje për takime ose adresime në faqe institucionale interneti. Informacioni i grumbulluar ka qenë i lidhur me projekte të veçanta të realizuara në kuadër të masave specifike, por në asnjë rast nuk është mundur të sigurohet informacion i plotë në nivel masash të realizuar prej disa institucioneve së bashku ose në paralel. I dobishëm vlerësohet komunikimi i drejtpërdrejtë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, e cila ka ofruar informacionin lidhur me aktorët e përfshirë në zbatimin e masave kryesisht agjenci ndërkombëtare të mbështetjes së huaj si: Programi i OKB-së për Zhvillim, PNUD, Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, GIZ, Programi i OKB-së për Mjedisin, UNEP etj. Mungesa e bazave të integruara të informacionit për ecurinë e projekteve dhe programeve për klimën në zbatim prej institucioneve të ndryshme, informacioni me të dhëna të papërditësuara në faqet e internetit të agjencive zbatuese dhe ndryshimi i stafëve teknike të përfshira në zbatimin e masave për klimën, e vështirëson procesin e monitorimit dhe pamundëson matjen e efektivitetit të masave të propozuara në PKV.

III. NJOHJE ME UDHËZIMET TEKNIKE PËR PLANIN KOMBËTAR TË VEPRIMIT

Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (SKNK), 2020-2030 është zhvilluar duke ndjekur “Udhëzimet Teknike për proceset e PKV”, i cili është hartuar nga grupi i ekspertëve për vendet më pak të zhvilluara në kuadër të Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar ndaj Ndryshimeve Klimatike, KKPKNK-së dhe është botuar në dhjetor të 2012 (i njohur ndryshe si “Udhëzime Teknike”). Proceset e PKV karakterizohen në Udhëzimet Teknike si:

- ✓ **Jo-përshkrimore:** Në Udhëzimet teknike propozohet copëzimi dhe marrja e masave të veprimit. Vendet duhet të përzgjedhin masat e duhura, që sigurojnë përshtatje efektive, duke marrë në konsideratë shkallën e progresit të bërë në nivel vendi, lidhur me përshtatjen dhe situatën konkrete.
- ✓ **Veprime që kanë autorësinë e vendit:** Është parë me rëndësi që drejtimi i këtij procesi të bëhet nga vendet, për të siguruar integritet dhe përshtatje të PKV me proceset e tjera të planifikimit dhe kredibilitetit politik. Synimi i proceseve PKV është t'i mbrojë dhe zhvillojë kapacitetet në nivel vendi, përmes mbështetjes nga partnerë të tjerë dhe sipas rrethanave.
- ✓ **Koherencë përshtatëse dhe planifikim zhvillimor:** Integrimi i veprimeve të përshtatjes në plane ka një rëndësi të veçantë, përkundër dukurisë së mbivendosjes, ose krijimit të strukturave paralele. Integrimi, po ashtu përfshin reflektim të nevojave në buxhetime.
- ✓ **Kusht që përmirëson menaxhimin e rrezikut nga klima:** Proceset PKV duhet të identifikojnë linjat e ndërhyrjes për të zvogëluar rrezikun nga klima, momentet e ndërhyrjes në proceset ekzistuese dhe mundësitë e bashkëfinancimit me burime private, publike, kombëtare ose ndërkombëtare.
- ✓ **Të monitorueshme në mënyrë të rregullt:** Ndërsa të mësuarit është pjesë e proceseve të hartimit të PKV, përditësimi i tyre në mënyrë të vazhduar është diçka që duhet të mbështetet.

Udhëzimet Teknike e shohin PKV-në si diçka që tejkalon zhvillimin thjesht të një plani formal. Ato e vënë theksin në karakterin ‘proces’ të PKV, përmes specifikimit të elementeve dhe hapave më poshtë. Një karakteristikë është se hartimi i PKV përfshin një nga hapat më poshtë:

-  **1. Shtron terrenin dhe adreson boshllëqet:** (a) identifikon dhe vlerëson organizimin dhe funksionimin institucional, programet, politikat dhe kapacitetet për koordinimin në tërësi; (b) vlerëson informacionin ekzistues në lidhje me ndryshimet klimatike përfshirë ndikimin, cenueshmërinë dhe masat e nevojshme dhe (c) vlerëson nevojat për zhvillim.
-  **2. Hartimi i PKV:** (a) hartimi i planeve, politikave dhe programeve për adresimin e boshllëqeve dhe nevojave të identikuara në pikën 1; (b) vlerëson nevojat afat-shkurtra dhe afat-gjata të përshtatjes; (c) promovon aktivitete që integrojnë ndryshimet klimatike në zhvillimin kombëtar dhe rajonal; (d) mban në konsideratë konsultimin me aktorët, (e) si dhe komunikimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin.

 **3. Strategjia e Zbatimit:** (a) përcakton sipas përparësisë rreziqet dhe cenueshmërinë nga ndryshimet klimatike; (b) forcon kuadrin institucional dhe ligjor për të mundësuar përshtatjen; (c) trajnime në nivel rajonal dhe sektorial; (d) publikon informacion mbi procesin e PNV-së, (e) dhe përfshirjen e/ndërlidhjen me nisma të tjera ndërkombëtare.

 **4. Raportimi, monitorimi dhe rishikimi:** (a) adreson mungesën e efikasitetit duke marrë parasysh mësimet e nxjerra dhe rezultatet shkencore të masave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe (b) jep informacion në komunikimet kombëtare mbi progresin e bërë.

IV. MONITORIMI I ZBATIMIT TË MASAVE SIPAS SEKTORËVE

Në këtë kapitull do të paraqesim në mënyrë të detajuar vlerësimin e masave prioritare të përshtatjes sipas sektorëve të mjedisit, turizmit, bujqësisë, shëndetësisë, mbrojtjes civile, etj.

4.1 Vlerësimi i përgjithshëm

1.1 Strategjia SKNK është miratuar në korrik 2019, ndërsa Plani i Veprimeve Prioritare, (PVP), i cili është pjesë e integruar e strategjisë starton në të shkuarën - viti 2017, duke krijuar një zhbaleancim dhe konfuzion me atë pjesë të nën-masave që i përket periudhës 2017-2019.

Rishikimi i dokumenteve strategjike dhe përditësimi i tyre është një problematikë e njohur në vend, për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe ekspertizës së nevojshme për ta bërë përditësimin.

Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike, e paraqitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) në 2017 priti një sërë komentesh, diskutimi i të cilave zgjati rreth 1.5 vjet. Në vitin 2019 kur MTM e rifuti në procesin e miratimit, stafi përgjegjës në njësinë për klimën, nuk e pati të mundur të bënte rishikimin financiar dhe kalendarik të gjithë veprimeve. Aktualisht, MTM ka në organikë 1 person me kohë të pjesshme të ngarkuar për klimën.

1.2 Objektivat e strategjisë për NK dhe ‘baseline’/ ose viti mbi të cilin projektohen objektivat e vendit për klimën;

Në nëntor të vitit 2015, Republika e Shqipërisë paraqiti KKP-në e saj të parë me angazhimin për të reduktuar me 11,5% shkarkimet e CO₂ gjatë periudhës 2016-2030, ndërsa rishikimi i vitit 2021 e rriti objektivin në 20.9% krahasuar me skenarin bazë, për të arritur një reduktim prej 708 kT CO₂ deri në vitin 2030³. Hartimi i dokumenteve strategjike për vendin, si SKNK dhe KKP bazohen në vlerësimin e shkarkimeve të raportuara prej vendit tonë në KKKBNK. Për këto dokumente, niveli referues i takon raportimit të bërë në Komunikimin e Tretë Kombëtar⁴, i publikuar në tetor 2016. Aktualisht, vendi po punon për Komunikimin e IV-t Kombëtar⁵.

Ndërsa lidhur me përshtatjen, në vitin 2016, GIZ ka realizuar një proces ‘Stocktaking of National Adaptation Plan’ (SNAP⁶), ku me ndihmën e një grupi ekspertësh u realizua një vlerësim i situatës në vend lidhur me përshtatjen. Viti bazë është kalibruar sipas inventarit kombëtar zyrtar të Gazeve me Efekt Serrë (GES) për vitin 2016. Sipas parimeve të parashtruara në "Udhëzimet Teknike të PKP", ky i fundit (plani), duhej konsideruar një proces me vlerë të shtuar, nëse mbështetej në strukturat dhe proceset ekzistuese të vendit. Në përputhje me këtë, inventarizimi i ‘status quo’ shihej si hapi fillestar i rëndësishëm për hartimin e një procesi të PKP-së, për adresimin në mënyrë të përshtatur të boshllëqeve.

³ Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar, (KKP) i rishikuar për Shqipërinë, 2021.

⁴ Third National Communication to the United Nations Framework Convention on Climate Change, 2016, https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/environment_energy/third-national-communication-to-the-united-nations-framework-con/

⁵ <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/projects/development-of-albania-fourth-national-communication-to-the-unfc.html>

⁶ GIZ: Guidance on applying the Stocktaking for National Adaptation Planning (SNAP) tool. Eschborn, 2014.

1.3 Analiza e inventarizimit të situatës në vend;

Siç përmendet edhe më lart, për analizimin e situatës ekzistuese në vend lidhur me përshtatjen, është përdorur mjeti analitik — *'Stocktaking for National Adaptation Planning'* (SNAP), i hartuar nga GIZ dhe aplikuar gjatë një seminari të organizuar më 19 shkurt 2015. Mjeti ofroi një përshkrim të kapaciteteve përshtatëse, që u panë në disponim të vendit dhe objektivave të synuara. Elementi kryesor i mjetit SNAP ishte vlerësimi i nevojave dhe kapaciteteve të vendit, që të lejonte zhvillimin e një perspektive strategjike mbi procesin e përgjithshëm të PKP-së. Zbatimi i tij ndihmoi në identifikimin e një pike të përbashkët nisjeje, nga e cila palët e interesuara mund të fillonin të formulonin një udhërrëfyes për procesin e PKP-së.

Kjo situatë ushtrimore u realizua përmes përfshirjes me pjesëmarrje të palëve të interesuara, që u vlerësuan si të rëndësishme për procesin e përshtatjes. Mjeti analitik përfshinte analiza dhe debate të përbashkëta, të dhënat e një pyetësori për "punën e heshtur", shpërndarë për pjesëmarrësit. Puna për hartimin e pyetësorit u bazua në 20 faktorë suksesi, të cilat u vlerësua se kishin një rëndësi vendimtare në procese të ngjashme, në vende të tjera.

Këta faktorë u grupuan në 7 fusha si: informacion për klimën, kapacitetet njerëzore dhe institucionale, vizioni dhe mandati afatgjatë, zbatimi, integrimi, pjesëmarrja, monitorimi dhe vlerësimi.

Analiza doli në përfundimet më poshtë:

-  Ekzistencën e një hendeku të shprehur mes situatës aktuale dhe qëllimit strategjik të SKNK. Tejkalmi i këtij hendeku do të kërkonte një proces ambicioz të hartimit të PKP.
-  Situata në lidhje me fushën e suksesit "Vizioni dhe Mandati Afatgjatë", mori një vlerësim mbi mesataren. Kjo për shkak të mandatit të qartë, që parashikonte Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 155, datë 19 shkurt 2015. Krejt ndryshe, dy faktorët e suksesit për këtë fushë (Vizionin Afatgjatë), siç ishin ekzistenca e planit koherent të përshtatjes dhe marrja në konsideratë e ndryshimeve klimatike në planin zyrtar, u vlerësuan si të dobët.
-  Mjeti SNAP e renditi situatën aktuale lidhur me informacionin mbi klimën shumë poshtë nivelit të nevojshëm.⁷ Nga diskutimet me përfaqësuesit e institucioneve: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Ministria e Zhvillimit Urban; Ministria e Energjisë dhe Industrisë; Ministria e Mjedisit; Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave⁸ - doli në pah, se megjithëse ekzistojnë studime të ndryshme, vlerësime dhe projeksione mbi klimën, ato nuk janë të njohura apo të aksesueshme nga ekspertët e sektorit. Për rrjedhojë, qasja në informacion dukej të ishte sfidë më e madhe, se vetë informacioni.
-  "Monitorimi dhe Vlerësimi" u rendit shumë nën mesataren. Kjo pasi procesi i PKP-së ishte në fazë të hershme dhe nuk ishte avancuar lidhur me monitorimin e progresit të tij (pra planit).

⁷ National Adaptation Plan for Albania <https://www.plan-adapt.org/projects/albania/#:~:text=How%20to%20Finance%20Climate%20Change%20Action%20in%20a%20Country%20That%20is%20at%20the%20Doorstep%20of%20the%20European%20Union>

⁸ Emërtimet e Ministrave në vitin 2016

Plani Kombëtar i Përshtatjes ka të renditura 15 veprime prioritare:

- Veprimi Prioritar 1:** Drejtimi i procesit të përshtatjes në Shqipëri;
- Veprimi Prioritar 2:** Krijimi i një pakete instrumentesh për integrim përshtatës ndaj Ndryshimeve Klimatike;
- Veprimi Prioritar 3:** Gatishmëria financiare për Klimën;
- Veprimi Prioritar 4:** Ngritja e një sistemi monitorimi për Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP);
- Veprimi Prioritar 5:** Nisma për informim dhe përfshirje të publikut;
- Veprimi Prioritar 6:** Nisma për ngritjen e kapaciteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike⁹;
- Veprimi Prioritar 7:** Ujitje, kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet;
- Veprimi Prioritar 8:** Menaxhimi i integruar i burimeve ujore;
- Veprimi Prioritar 9:** Përshtatja në sektorin bujqësor;
- Veprimi Prioritar 10:** Nxitja e zbatimit të strategjisë së përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e shëndetësisë;
- Veprimi Prioritar 11:** Plan i integruar ndërsektorial për zonën e bregdetit;
- Veprimi Prioritar 12:** Nisma për krijimin e planeve të përshtatjes në nivel bashkie;
- Veprimi Prioritar 13:** Përshtatja në turizëm;
- Veprimi Prioritar 14:** Rritja e nivelit të gatishmërisë së mbrojtjes civile dhe zvogëlimit të riskut të fatkeqësive natyrore;
- Veprimi Prioritar 15:** Rikuperimi i lagunës Kune-Vain.

⁹ Veprimi Prioritar (VP) 5 & 6 janë adresuar në Raportin e I-rë të Monitorimit të input-eve për klimën. (V.P.5 pg.57 & V.P. 6 pg. 51) <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/monitoring-climate-change-strategy-albania>

4.2 Vlerësimi i masave për sektorin e mjedisit

Veprimi Prioritar 1: Drejtimi i procesit të përshtatjes në Shqipëri

Ministria Kryesuese Përgjegjëse: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Shqipëria ka zhvilluar dhe zbatuar një numër të madh të politikave, strategjive, planeve, programeve, projekteve dhe masave që lidhen me përshtatjen. Vendi ka identifikuar masat prioritare të përshtatjes në:

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020;
- Komunikimin e Tretë Kombëtar;
- Politikën Kombëtare për Ndryshimet klimatike dhe në SKNK;
- Planin e saj Kombëtar të Përshtatjes; Planin e Përshtatjes për Tiranën;
- Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2019-2023;
- Politikën Kombëtare për Pyjet 2019-2030;
- Planin e Integruar Ndër-sektorial të zonës Tiranë-Durrës;
- Programin Kombëtar të Fondit të Gjellbër për Klimën, që u hartua sipas metodës me pjesëmarrje bazuar në dokumentet e mëparshme.

Këto dokumente identifikojnë një numër shumë të madh të masave të përshtatjes. Masat janë kategorizuar dhe përmbledhur në Kontributin Kombëtar të Pikësnyuar (KKP) i rishikuar për Shqipërinë¹⁰. Zbatimi i këtyre masave, në frymën e objektivave të përshtatjes të Marrëveshjes së Parisit, është vlerësuar se do të rriste kapacitetin përshtatës, forconte aftësinë ripërtëritëse dhe do të zvogëlonte ndikimin e ndryshimeve klimatike. Gjithashtu do të kontribuonte në zhvillimin e qëndrueshëm për të siguruar reagimin e duhur të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në kontekstin e objektivit të temperaturës, të përmendur në nenin 2 të Marrëveshjes së Parisit¹¹.

Prioritarizimi i masave të përshtatjes në kuadër të punës për KKP-në e rishikuar, 2021 nxjerr në pah “masat e lehta” në drejtim të përshtatjes, që nëse miratohen mund të krijojnë përfitime të shumta. Qeveria ka njohur po ashtu, rëndësinë e planifikimit, buxhetimit dhe zbatimit të masave më komplekse, specifike dhe të kushtueshme.

Pavarësisht barrierave ekzistuese për planifikimin efektiv të PKP, integrimi i treguesve të NK është synuar kryesisht për sektorë me ndjeshmëri ndaj klimës si bujqësia, energjia, turizmi dhe shëndetësia. Në vitin 2017, GIZ ka punuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për integrimin e masave të përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (NK) në Procesin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2018-2020 si pjesë e një programi pilot të integritit. Do të ishte me interes që lidhur me këtë të kishte një lloj raportimi progresiv dhe të aksesueshëm për aktorët e interesuar, për çfarë ka qenë performanca e zbatueshmërisë dhe realizimit të këtyre masave. Për sa i përket vendit që zë klima në vizionin e qeverisë për zhvillimin e vendit, ka një integrim të hershëm të treguesve PKP në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI), por planifikimi i përshtatjes kërkon integrim të mëtejshëm që duhet vijuar me politikat dhe programet e qeverisë. Për shembull, SKZHI përmend PKP, por nuk përfshin një mënyrë për të rivlerësuar dobësitë klimatike dhe për të matur progresin

¹⁰ Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar, (KKP) i rishikuar për Shqipërinë, Tabelat 19-25, fq. 70.

<http://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/3.-Kontributi-Komb%C3%ABtar-i-Percaktuar-KKP-i-rishikuar-p%C3%ABr-Shqip%C3%ABrin%C3%AB-1.pdf>

¹¹ https://unfccc.int/sites/default/files/resource/parisagreement_publication.pdf

e PNK- së në baza të rregullta¹². Procesi i PKP, duke u zgjeruar në Dokumentin Kuadër të PKP-së, është parashikuar të ndërtojë dhe forcojë kapacitetet e qeverisjes qendrore dhe vendore, përsa i përket integritetit të NK në strategjitë zhvillimore, me synimin për të promovuar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të kërcënuara nga NK, për të nxitur investimet për klimën dhe për të zbatuar politika sektoriale të ndjeshme ndaj klimës. Përpjekjet ekzistuese të integritetit bazohen në kuadrin ekzistues të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit në Shqipëri. Megjithatë, sikundër është theksuar edhe në gjetjet e raportit të I-rë të “Monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike”¹³ nevojitet integrim efikas dhe i strukturuar i treguesve të NK, pasi buxheti ndërmjet sektorëve bëhet më i efektshëm.

Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP) është hartuar nga GIZ si një dokument më vete në trajtën e një Strategjie të Përshtatjes me Klimën, së bashku me Planin e Masave të Përshtatjes, punë e cila është shtrirë gjatë viteve 2015-2017. Nga ky dokument është nxjerrë Plani i Masave të Përshtatjes (ose Plani i Veprimeve Prioritare), i cili është integruar si pjesë përbërëse e SKNK. Ndërkohë ‘*Readiness and Preparatory Support Proposal*’¹⁴ zhvilluar nga PNUD në Tiranë, paraqitur për miratim pranë Fondit të Gjellbër për Klimën (GCF) në tetor 2019 - e trajton zbatueshmërinë e masave të përshtatjes, duke e konsideruar PKP si dokument që do të miratohej në trajtën e propozuar, gjë që nuk ka ndodhur. Shqipëria nuk ka miratuar një Strategji Kombëtare (SK) të përshtatjes, që qëndron si dokument më vete.

Veprimi Prioritar 2: Krijimi i një pakete instrumentesh për integrim përshtatës ndaj Ndryshimeve Klimatike

Ministria Kryesuese Përgjegjëse: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ky veprim prioritar që kryeson Planin e veprimtarive prioritare të SK për NK do të duhej të përfshinte:

- Thjerrën klimatike;
- Qëndrueshmërinë Klimatike;
- Vlerësimin Strategjik Mjedisor, me ndjeshmëri klimatike;
- Treguesit e shpenzimeve klimatike.

1. Hartimi i instrumenteve për integrimin e Ndryshimeve Klimatike: ecuria dhe institucionet e përfshira.

Në Shqipëri nuk ka një proces të hartimit të instrumenteve për klimën. Në fakt nga 15 masat, 5 të parat janë të tejkaluara si detyra, ku institucioni përgjegjës ishte MTM. Përmes tyre synohej të arrihej përfshirja e aktorëve dhe institucioneve të ndryshme drejt përmbushjes së detyrimeve kuadër të vendit ndaj Marrëveshjes së Parisit. Në këtë kontekst, duhen krijuar edhe instrumentet e sipër përmendur, realizimi i të cilave duket se sheh nga e ardhmja.

¹² Plani Kombëtar për Përshtatjen (PKP) ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri. Kuadri për Procesin e Vendi, Qershor 2016

¹³ <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/monitoring-climate-change-strategy-albania>

¹⁴ <https://www.greenclimate.fund/sites/default/files/document/readiness-proposals-albania-undp-adaptation-planning.pdf>

Për shkak të organizimit dhe të përfaqësimit institucional gjatë hartimit të PKP, të përshkruar edhe më sipër në këtë dokument vlerësohet se prioritetet e PKP jo domosdoshmërisht përfaqësojnë paraqitjen më të mirë dhe më të plotë të prioriteteve të vendit. Vlen të thuhet se kemi një shkëputje mes kontekstit të strategjisë dhe nevojave reale të vendit, nisur edhe nga fakti se disa prej masave/veprimeve prioritare të SKNK u vendosën bazuar në prioritetet e fushave ku disa nga donatorët kishin projekte dhe financime aktive. Është tashmë praktikë e njohur që këto procese të udhëhiqen nga donatorët. Ndër ministritë më aktive të asaj periudhe ishte ajo e Planifikimit Urban, përfaqësuesit e së cilës, paraqitën një sërë masash konkrete, që synonin të rrisnin aftësinë përballuese ndaj ndryshimeve klimatike në nivelin vendor. Me ristrukturimin e qeverisë dhe mbylljen e kësaj ministrie këto detyra i kaluan Ministrisë së Brendshme, të cilat 'de-facto' nuk janë ndjekur më tej. Prej asaj kohe dhe deri në fund të periudhës së monitoruar në këtë dokument nuk ka pasur asnjë proces vlerësimi apo rishikimi me qëllim përmirësimin e PKP.

Strategjia cilëson ekzistencën e një strukture në nivel qendror, përgjegjëse për zbatimin e strategjisë së ndryshimeve klimatike që është GNPKNK.

2. Cili është parimi mbi të cilin mbështet funksionimi i grupit ndërministror për klimën? Çfarë janë vendimet e tij dhe si bëhet transparenca?

Grupi Ndërministror i Punës për Ndryshimet Klimatike, GNPKNK është krijuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 155 datë 19 shkurt 2015. Sipas KKP së miratuar me VKM Nr. 762 (2015), GNPKNK do të duhej të ristrukturohej për t'iu përshtatur strukturës së qeverisë së re, pas reformës territoriale. Në përbërje të tij, marrin pjesë 15 ekspertë të nivelit teknik të linjës kryesore dhe synimi është koordinimi i të gjitha institucioneve të përfshira në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Roli i tij gjithashtu është të lehtësojë integrimin e ndryshimeve klimatike në planet e reja përkatëse, politikat, programet dhe aktivitetet ekzistuese. GNPKNK kryesohet nga Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit, pasi MTM është pika qendrore në ushtrimin e detyrës, në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK). Megjithatë formalisht është ngritur një strukturë e rëndësishme në nivelin e qeverisjes qendrore, siç është Grupi Ndërministror i Punës për Ndryshimet Klimatike, mandati i tij përsa i përket përshtatjes nuk ka qenë i qartë¹⁵.

Nga konsultimi i burimeve të informacionit zyrtar të qeverisë, nuk u gjetën informacione të asnjë lloji për funksionimin e kësaj njësie ndër-qeveritare për klimën. Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri (REC Shqipëri) iu drejtua disa herë me kërkesa edhe faqes zyrtare për botimet qeveritare (QBZ.al) për të siguruar vendimet për krijimin e GNPKNK, por vendimet e referuara në disa prej raporteve të hartuara nga asistencë e huaj për Shqipërinë, si të lidhura me krijimin e GNPKNK nuk u arrit të gjendeshin. Në komunikimin me MTM është konfirmuar mos funksioni i tij prej vitit 2018 e në vazhdim dhe nevoja për riaktivizimin e tij me qëllim adresimin institucional të masave që duhen marrë në kuadër të rishikimit të KKP (nëntor 2021).

3. Realizimi i tre projekteve pilote për klimën (sikundër projektojnë indikatorët – 1 projekt pilot/ vit) tre vite pas miratimit të SK për NK.

¹⁵ Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar (KKP), 2016.

1. Projekti KUNE-VAİN i kryer nga Programi i OKB-së për Mjedisin (UNEP) ka përfunduar.

2. GIZ është në procesin e hartimit të një projekt propozimi me vlerë rreth 40.000.000 USD për masat përshtatëse, i cili është në fazë koncept-ideje. Propozimi do të aplikohet në GCF për të zhvilluar informacionin dhe shërbimet për klimën në drejtim të përshtatjes. Koncepti fokusohet në dy komponentë kryesorë:

Komponenti i parë ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave për klimën (përshtatjen) si: temperatura, precipitimi, prurjet në lumenj etj., që do të ndihmojë në sistemin e paralajmërimit të hershëm të dukurive ekstreme të motit.

Komponenti i dytë ka lidhje me masat që bazohen në qasjen me bazë ekosistemi, që pritet të shtrihen në nivelin e pushtetit vendor, duke zhvilluar strategji vendore dhe projekte pilote investimi në drejtim të përshtatjes me ndryshimet klimatike.

Ky projekt pritet të fillojë zbatimin në vitin 2023 dhe vlerësohet si një ndër projektet e para pilot që do të nisin punën pas hartimit të SKNK.

3. Në sektorin e Emergjencave Civile, projektet e financuara përgjatë 2019-2021 janë:

“TË JEMI GATI – Përmbytjet dhe zjarri në pyje, parashikimi dhe menaxhimi i riskut”, financohet në kuadër të Programit Interreg IPA CBC Itali – Shqipëri – Mali i Zi.

Buxheti: 5.009.633 Euro. **Kohëzgjatja:** shtator 2019 – qershor 2022.

Qëllimi: Projekti synon adresimin e një sfide të përbashkët mes vendeve që lagen nga Adriatiku (Itali, Shqipëri dhe Mali i Zi), zona që vitet e fundit janë prekur nga fatkeqësi të ndryshme natyrore, si edhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut, me vëmendje të veçantë ndaj rrezikut të zjarreve në pyje dhe përmbytjeve.

Autoriteti kontraktues: Bashke-financuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA II)

“Resilience Strengthening in Albania” – RESEAL-UNDP

Buxheti: 820.595.USD. **Kohëzgjatja:** korrik 2020 - prill 2024

Qëllimi: Të përshpejtojë transformimet strukturore, si dhe zbutjen e varfërisë në të gjitha format dhe dimensionet e saj.

Partnerët: UNDP. **Financuar nga:** Qeveria Portugeze/ Bashkëpunimi Suedez për Zhvillimin Ndërkombëtar (SIDA)

“Forcimi i kapaciteteve të strukturave operationale të mbrojtjes civile në mjete, pajisje dhe burime njerëzore”

Buxheti: 30.000.000 Euro. **Financuar:** Në formë kredie/ hua nga Qeveria Italiane

Veprimi Prioritar 3: Gatishmëria financiare për Klimën

Ministria Kryesuese Përgjegjëse: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

1. A ka arritur Shqipëria të aksesojë fondin prej 3.000.000 USD të synuar për klimën, që do të mundësonte rristurimin e Fondit të Gjellbër për Klimën?

Ky fond quhet i aksesuar, me projektin “Readiness” që GCF i ka financuar PNUD-it.

Projekti është miratuar me VKM Nr. 762 në 2019. Fondi i Gjellbër i Klimës (Green Climate

Fund, GCF) është një fond i ri global i krijuar nga vendet palë në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), për të mbështetur përpjekjet e vendeve në zhvillim, që t'i përgjigjen sfidës së ndryshimeve klimatike. GCF kërkon të promovojë kalimin në një model zhvillimi rezistent ndaj klimës dhe me shkarkime të ulëta, duke marrë në konsideratë nevojat e vendeve që janë veçanërisht të prekshme nga ndikimi i ndryshimeve klimatike.

GCF përdor investimet publike për të stimuluar financat private në nxitjen e investimeve miqësore me klimën. Fondi luan një rol të rëndësishëm në shërbim të Marrëveshjes së Parisit dhe në mbështetjen e vendeve në zhvillim, në zbatimin e Kontributeve të Përcaktuara Kombëtare. GCF përgjigjet pranë Kombeve të Bashkuara dhe udhëhiqet nga parimet dhe dispozitat e KKBNK.

Ky program i vendit dhe korniza e tij strategjike janë zhvilluar si pjesë e Fondit të Gjellbër për Klimën - Programi i gatishmërisë dhe mbështetjes përgatitore. Projekti titullohet "Zhvillimi i kapaciteteve të Shqipërisë për një angazhim efektiv me Fondin e Gjellbër të Klimës" dhe realizohet në partneritet me Programin e OKB-së për Mjedisin (UNEP).

Qëllimi i projektit "**Gatishmëria dhe mbështetja përgatitore**" (ose "Readiness") është nxitja e një procesi të planifikimit afat-shkurtër dhe afat-gjatë të përshtatjes me ndryshimet klimatike përmes Planit Kombëtar të Përshtatjes. Projekti është hartuar me synimin për të ndihmuar Qeverinë e Shqipërisë të rrisë kapacitetet në adresimin e çështjeve që lidhen me cenueshmërinë si pasojë e ndryshimeve klimatike.

Arritjet e pritshme të projektit përfshijnë¹⁶:

Rezultati 1: Fuqizimi i mandatit, strategjisë dhe mekanizmit koordinues me fokus vlerësimin dhe adresimin e hendeqeve që kanë të bëjnë me kapacitetet në sektorët prioritarë, siç janë turizmi, zhvillimi urban, bujqësia, transporti dhe energjia;

Rezultati 2: Zhvillimin e Strategjisë dhe të PKP;

Rezultati 3: Zhvillimi i strategjive të financimit, monitorimit dhe vlerësimit për të siguruar institucionalizim afatgjatë të kapaciteteve dhe mundësive të financimit lidhur me përshtatjen, përtej kohës së zbatimit të këtij projekti.

Përfituesit kryesorë janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Instituti Shqiptar i Gjeoshkencës (ish Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, IGJEUM). Përfituesit jo të drejtpërdrejtë janë ministrinë e tjera dhe pushtetet vendore që marrin mbështetje në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve brenda sektorëve prioritarë, si dhe sektorë të tjerë që janë të përfshirë në NK, si: komuniteti akademik, OSHC-të dhe kompanitë private.

Shuma: 2.297.907 USD **Kohëzgjatja:** 48 Muaj (4 vite) 2021-2024

Projekti është në fazën fillestare të zbatimit të aktiviteteve të tij. Gjatë muajit dhjetor 2021, është organizuar aktiviteti prezantues i tij me aktorë të ndryshëm dhe është diskutuar plani i punës dhe veprimet e pritshme të projektit, sipas sektorëve prioritarë. Më tej, është përcaktuar struktura drejtuese e projektit (Komiteti Drejtues), i cili ka përfshirjen e gjerë të institucioneve dhe agjencive, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Fillimi i 2022, parashikon nisjen e punës për hartimin e dokumenteve bazë sipas sektorëve të

¹⁶ <https://www.greenclimate.fund/sites/default/files/document/readiness-proposals-albania-undp-adaptation-planning.pdf>

ndryshëm. Komponenti gjinor dhe plani i komunikimit me publikun e gjerë vlerësohen si aktivitete të rëndësishme për t'u zbatuar në vazhdimësi të punës për zbatimin e tij.

2. Performanca e indikatorit që lidhet me rritjen e kapaciteteve të Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar (AKP)

Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (*Anglisht: National Designated Authority*) është ngritur që në vitin 2012 jo si njësi, por si një detyrë funksionale e lidhur me një pozicion të përcaktuar në strukturën e MTM. Në periudhën e miratimit të strategjisë ka qenë ngarkuar Zv. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Znj. Ornella Çuçi, ndërsa aktualisht personi i ngarkuar si pikë fokale e GCF, pranë MTM është Z. Sofjan Jaupaj.

3. Realizimet përkundrejt angazhimit financiar prej 37.500.000 lekë në tre vite të strategjisë.

Gjatë periudhës tre vjeçare që përfshin analiza monitoruese e zbatimit të strategjisë, MTM nuk ka pasur fonde të alokuara nga buxheti i shtetit për projekte të përcaktuara si veprime në zbatim të SKNK. Kontributi i MTM ka vijuar të jetë mbulimi i pjesës së TVSH për projektet e miratuara, ose të financuara prej fondeve të huaja. Duke mos qenë i mundur gjurmimi i fondeve të dhëna për klimën, mund të thuhet vetëm si vlerësim i tërthortë se ky angazhim është mbuluar përmes mbështetjes së huaj për vendin. Lidhur me nivelin e angazhimit, vlerësohet se fondi në dispozicion (rreth 310.000 Euro) është shumë i vogël për të adresuar problematikat e klimës përmes zbatimit të masave përshtatëse.

Veprimi Prioritar 4: Ngritja e një sistemi monitorimi për Planin Kombëtar të Përshtatjes (PKP)

Ministria Kryesuese Përgjegjëse: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

1. A është bërë ndonjë përpjekje për të konceptuar dhe ngritur sistemin e monitorimit të PKP?

Ndërkohë nuk ka ndonjë përpjekje të ngritur sistemin për monitorimin e zbatimit të masave për klimën. Projekti "Gatishmëria dhe mbështetja përgatitore"/"Readiness" i PNUD pritet të japë kontribute në këtë çështje. Projekti i PNUD e vlerëson si thelbësor krijimin e sistemeve që identifikojnë jo vetëm prioritetet, planet e veprimit, por edhe që ndajnë përgjegjësitë lidhur me NK, si dhe mundësojnë thithjen e investimeve për NK. Aktualisht nuk ekzistojnë protokollat e monitorimit dhe vlerësimit për të gjurmuar projektet dhe programet që lidhen me NK në nivel kombëtar. Është identifikuar nevoja për një monitorim të koordinuar dhe të bazuar në rezultate për të kuptuar progresin e përgjithshëm, jo vetëm në nivel projekti.

Një nga arritjet e pritshme të këtij projekti është zhvillimi i një Strategjie për Financimin dhe Monitorim & Vlerësimin e PKP. Hartimi i këtij dokumenti parashikohet të ndodhë në periudhën e fundit të zbatimit të projektit.

Disponueshmëria e të dhënave të përditësuara dhe cilësore ka një ndikim të rëndësishëm në aftësinë për të marrë vendime të informuara dhe në efektivitetin e menaxhimit të NK. Aktualisht, nuk ka një platformë të harmonizuar për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave për NK. Në përgjithësi, Monitorimi dhe Vlerësimi (M&V) vlerësohet në nivel të kufizuar dhe shtrohet nevoja për M&V specifik dhe të fokusuar për klimën - si ndaj

përshtatjes, ashtu edhe zbutjes. Përmeshja e tij do të plotësonte ndërtimin e vazhdueshëm të kapaciteteve në kuadër të projekteve dhe nismave ekzistuese, me fokus në zhvillimin e treguesve të NK me ndjeshmëri gjinore dhe integrimin e tyre në sistemin kombëtar të monitorimit mjedisor.

Veprimi Prioritar 15: Rikuperimi i Lagunës Kune-Vain

Ministria Kryesuese Përgjegjëse: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

MTM ka zbatuar projektin e mbështetur nga Fondi Global i Mjedisit (GEF) dhe UNDP për të rritur kapacitetet përshtatëse të Sistemit të Lagunës Kune - Vain, bazuar në shërbimet e ekosistemit. Për adresimin e nevojave në zonën e mbrojtur është identifikuar një grup i integruar ndërhyrjesh përshtatëse, përfshirë monitorimin e bazuar në ekosistem.

1. A ka pasur ndërhyrje për zhvillimin e kapaciteteve përshtatëse me bazë ekosistemin (EbA)?

Projekti "Rritja e kapaciteteve përshtatëse të Lagunës Kune-Vain (KV) bazuar në shërbimet e Ekosistemit (EbA) në Shqipëri" financohet nga Fondi Special i Ndryshimeve Klimatike (Special Climate Change Fund, SCCF) nëpërmjet një granti prej 1.903.000 USD. Projekti ka nisur zyrtarisht në qershor 2016. Kohëzgjatja fillestare e projektit ishte 36 muaj, por zbatimi i tij mori një periudhë disa mujore kohë edhe nga viti 2020.

Sistemi i lagunës Kune - Vain (SLKV) përballet me një sërë sfidash që mund të përkeqësohen si pasojë e ndryshimeve klimatike dhe dëmtojnë kapacitetin e SLKV në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve që janë thelbësore për komunitetet lokale. Projekti kishte si synim rritjen e kapaciteteve pranë qeverisë dhe komuniteteve lokale që jetojnë pranë SKVLS për t'ju përshtatur ndryshimeve klimatike, duke përdorur një grup të integruar ndërhyrjesh përshtatëse, përfshirë dhe EbA. Projekti kishte tre komponentë:

- ✓ Komponenti 1: Kapacitetin teknik dhe institucional për të adresuar rreziqet e ndryshimeve klimatike përmes EbA;
- ✓ Komponenti 2: Minimizimin e ndikimit të klimës nëpërmjet demonstrimit të praktikave më të mira dhe ndërhyrjeve konkrete EbA dhe të tjera përshtatëse në sistemin e lagunës Kune-Vaini; dhe
- ✓ Komponenti 3: Ndërgjegjësimin dhe njohuritë në lidhje me praktika efektive të EbA.

Projekti u zbatua nga Njësia e Mjedisit në OKB-së në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2. A janë hartuar udhëzues teknike EbA?

Në lidhje me integrimin e qasjeve të EbA, projekti ka prodhuar udhëzime dhe protokolle që janë paraqitur në trajnime. Udhëzimet teknike për EbA janë zhvilluar nga një konsulent ndërkombëtar EbA, të cilat janë prezantuar dhe shpërndarë për pjesëmarrësit në veprimtaritë trajnuese në muajt tetor dhe nëntor 2018.

Megjithatë, strategjia e zgjerimit të EbA edhe në zona të tjera është zhvilluar në vitet 2018-2019, për të kontribuar në integrimin e EbA. Për ta mbështetur këtë proces, projekti duhet të vazhdojë të ndajë dhe komunikojë rezultatet e tij në forumet e duhura, me rëndësi strategjike për procesin.

3. A është hartuar ndonjë dokument strategjik për monitorimin e ndërhyrjeve në lagunë?

Pjesë e monitorimit të gjendjes së lagunës ka qenë vlerësimi ekologjik i indikatorëve mjedisore, si matja e parametrave fiziko-kimike të ujërave të lagunës, të fitoplanktonit¹⁷, zooplanktonit¹⁸ dhe shpendëve, të kryer në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Ky monitorim është kryer në periudhën 2018-2019 dhe ka prodhuar një sërë referimesh shkencore dhe një dokument reference monitorimi¹⁹, që mund të shërbejë si standard monitorimi për këtë lagunë. Ngjashëm, ky standard mund të zbatohet edhe në të gjithë sistemin e lagunave të bregdetit shqiptar.

4. A janë ndërmarrë fushata ndërgjegjësuere lidhur me avantazhet e përshtatjes me bazë ekosistemin?

Në kuadër të projektit janë kryer një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuere nga REC Albania, si pjesë e aktiviteteve të projektit EbA, ku përfshihej:

- ✓ Festimi i Ditës Botërore të Ligatinave me shkollat pranë KVLS-së me angazhim të plotë të stafit të REC, OJF-ve vendore dhe partnerëve lokalë;
- ✓ Printimi i materialeve promovuese (çanta, stilolapsa, dosje, fletore etj.);
- ✓ Dita e Tokës: 22 Prilli – Aktivitetet e shkollës mbi aktivitetin Bio Blitz;
- ✓ Festimi i Ditës Botërore të Biodiversitetit me shkollat pranë SLKV me sloganin “Festimi i 25 vjetorit të biodiversitetit”;
- ✓ Organizimi i aktiviteteve të vëzhgimit të shpendëve;
- ✓ Dita Evropiane e Parqeve - Promovimi i EbA dhe projektit në TV dhe media kombëtare;
- ✓ Ekspozita Udhëtuese: Finalizimi i 30 fotografive të llojeve kryesore të SLKV për aktivitetin e ekspozitës udhëtuese;
- ✓ Pjesëmarrja dhe prezantimi i Planit të Komunikimit dhe Vizibilitetit për Trajnimin Kombëtar.

Këto aktivitete kanë ndihmuar proceset e informimit dhe të ndërgjegjësimin të komuniteteve vendore mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në ekosisteme shumë të ndjeshme si ligatinat. Rreth 100 banorë lokalë, mbi 300 nxënës dhe 30 biznese kanë marrë pjesë në aktivitete ndërgjegjësuere në zonën e Kune - Vainit dhe Shëngjin. Ruajtja, mbrojtja e biodiversitetit dhe habitateve natyrore nga erozioni detar, ndryshimi i cilësisë së ujërave dhe llojet aliene që zhvendosen në këto mjedise nga zonat më të ngrohta janë të rëndësishme për të ruajtur produktivitetin e këtyre ekosistemeve dhe shumë lloje të tjera që ushqehen, riprodhohen dhe folezojnë në to - si shpendë, peshq, artropodë, bimë ujore, etj. Pjesëmarrja e komunitetit në menaxhimin dhe ruajtjen e këtyre ekosisteme është thelbësore për të shmangur presionet shtesë mbi këto ekosisteme.

¹⁷ Fitoplanktonet janë organizma planktonikë bimorë, të cilat janë shumë të rëndësishme në ekosistemet e ujërave të ëmbla, dhe detare.

¹⁸ Zooplanktonet janë organizma planktonikë shtazore heterotrofikë të rëndësishëm për mjediset ujore.

¹⁹ www.kunevain.com

4.3 Vlerësimi i masave për sektorin e turizmit

Veprimi Prioritar 13: Përshtatja në turizëm

Ministria përgjegjëse: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

1. A është hartuar një strategji sektoriale që merr në konsideratë çështjet klimatike? Çfarë mbështetje u është ofruar sektorëve vendorë lidhur me klimën?

Nuk ka një strategji sektoriale që merr në konsideratë çështjet e klimës në Shqipëri. Gjatë vitit 2022, përfaqësues të asistencës së huaj për Shqipërinë (konkretisht Agjencia Suedeze për Zhvillim të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Sida) ka referuar planet e saj lidhur me dhënien e mbështetjes për Shqipërinë për hartimin e strategjisë kombëtare të mjedisit, ku klima pritet të jetë një komponent i rëndësishëm i saj. Por ende nuk ka informacion të publikuar lidhur me nivelin dhe kohën e hartimit të këtij dokumenti strategjik. Ndërkohë, në nivelin e planeve sektorial, GIZ ka bërë një sërë rishikimesh dhe ka dhënë kontribute lidhur me planet kombëtare të territorit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT). Këto dokumente sektoriale kanë qenë nën nismën “Shqipëria 2020-2030”²⁰. Të tilla referohen për Planin për Bregdetin²¹ dhe Planin i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit²².

4.4 Vlerësimi i masave për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural

Veprimi Prioritar 7: Ujitje, kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet

Ministria përgjegjëse: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

1. Modernizimi dhe reformimi i strukturave në dy fusha: a) të ujitjes dhe kullimit b) përmbytjeve. Procedura të besueshme financiare. Si rezulton të jetë funksionimi i procedurave financiare?

Ministria përgjegjëse (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural) ka një drejtori të veçantë për administrim e tokës dhe ujërave me dy sektorë, njëri prej të cilëve është përgjegjës për ujitjen dhe kullimin. Ndërkohë, nuk ka ndonjë strukturë të veçantë të lidhur me përmbytjet, por kjo shihet si detyrë funksionale e sektorit të përmendur më sipër. Gjatë vitit 2021, është diskutuar për një ristrukturim të strukturës aktuale, por është e paqartë nëse ndryshimet do të prekin këta sektorë duke i forcuar apo reformuar më tej.

Të gjitha financimet e dhëna nga kjo ministri që janë të lidhura me programe me ndikim në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në sektorët e bujqësisë dhe të blegtorisë, kryhen përmes Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)²³. Por duhet theksuar se nuk ka financime të lidhura drejtpërdrejtë me përmbytjet. Ndërkohë, pjesa e ndërhyrjeve në ujitje dhe kullim shihet si pjesë e financimeve më të gjera, si për shembull projektet në kuadër të thirrjes për propozime për ndërhyrje fizike në fermë, në programin e Kuadrit të

²⁰ http://planifikimi.gov.al/index.php?id=akpt_about

²¹ http://planifikimi.gov.al/index.php?id=pins_bregdeti

²² http://planifikimi.gov.al/index.php?id=ppk_shqiperia

²³ <http://www.azhbr.gov.al/>

Instrumentit Ndhmës për Para-anëtarësim të Zhvillimit Rural (IPARD II), me 75% të financimit nga fondet e BE dhe 25% nga fondet e qeverisë shqiptare.

Procedura e thirrjeve është e shpallur në faqen e zyrtare të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR) së bashku me formularët e aplikimit. Po në këtë faqe, gjenden të shpallura edhe përfituesit e mbështetjeve të dhëna²⁴.

Duhet të theksojmë se është i pamundur vlerësimi i shumave të mbështetjes me efekt të drejtpërdrejtë në projektet përshtatëse për klimën, apo edhe vlerësimi i efektivitetit të procedurave në këtë drejtim, meqë nuk ka asnjë material monitorimi të bërë publik, apo të referuar gjatë takimeve në institucionet përgjegjëse.

2. Plan për pakësimin e erozionit. Studim fizibiliteti për burimet ujore. A ka ndonjë studim fizibiliteti të 2019-2021 për burimet ujore?

Në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), sektori për mbrojtjen e tokës është përgjegjës edhe për hartimin e masave anti-erozion. Deri më tani nuk ka asnjë plan ose dokument strategjik për adresimin e erozionit dhe masat për pakësimin e tij. Efektet përmirësuese për erozionin referohen vetëm në dokumentet lidhur me menaxhimin e pyjeve dhe masat ripyllëzuese, si p.sh. “Dokumenti i Politikave për Pyjet në Shqipëri – 2030”, hartuar nga MTM në vitin 2018²⁵.

Në sektorin e burimeve ujore, kemi Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (MIBU) 2018, hartuar nga MBZHR. Ndërkohë, Programi Kombëtar Sektorial për menaxhimin e integruar të ujit, 2018-2030 është hartuar në kuadër të nismës Shqipëria 2020-2030. Ky dokument synon të garantojë koordinimin e procesit të planifikimit të financimeve në sektorin e ujit, që vijnë nga pushteti qendror, nga mbështetja e partnerëve zhvillimorë, si dhe në bashkërendimin me njësitë e qeverisjes vendore për programimin e investimeve në sektor. Por vlen të theksojmë se gjatë periudhës së monitoruar nuk ka pasur zhvillime ligjore, përmirësuese apo monitoruese për këto dokumente, duke pamundësuar vlerësimin e efektivitetit të tyre.

3. Si funksionon bashkëpunimi me IGJEO për shkëmbimin e të dhënave hidrologjike?

Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO) është institucioni përgjegjës për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave lidhur me reshjet dhe prurjet në lumenj. Referimi prej institucioneve të ndryshme, përfshirë edhe partnerë të huaj dhe agjencitë zbatuese, e cilësojnë si problematike shkëmbimin e të dhënave me Institutin e Gjeoshkencave (ish Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, IGJEUM) në periudhën e para 2020-ës. Ndryshimet në strukturat drejtuese të IGJEO kanë sjellë një hapje të institucionit dhe një qasje më bashkëpunuese në këtë drejtim. Disa nga programet në fushën e ndryshimeve klimatike, të zbatuara nga GIZ, PNUD, etj., përfshijnë në planifikimet e tyre, aktivitete konkrete që synojnë fuqizimin e ndërveprimit institucional mes aktorëve të ndryshëm dhe IGJEO, ku bën pjesë edhe fuqizimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm mbi përmbytjet.

4. Ngritja e strukturave të kontrollit teknik për mbrojtjen nga përmbytjet - Si funksionon kontrolli teknik, çfarë është struktura?

²⁴ <http://www.azhbr.gov.al/thirrja-2/>

²⁵ <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/DPP-17.12.2018.pdf>

Kontrolli teknik për përmbytjet vlerësohet si një detyrë e shpërndarë ndërmjet disa institucioneve, përfshirë Agjencinë e Emergjencave Civile, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, etj.

Në shtator 2020 është riaktivizuar Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), i ngritur me VKM që në vitin 1993²⁶.

5. Harta e përmbytjes - A ka një hartë të përmbytjes? Si përditësohet?

Harta e përmbytjeve është hartuar prej Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), në kuadër të mbështetjes së dhënë prej programeve të asistencës së huaj. Ajo është pjesë e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC), i cili është dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e emergjencave civile. Hartat gjenden në nivel prefekturë, kuptohet për ato prefektura që janë të prekura nga përmbytjet e lumenjve si ajo Shkodër, Lezhë, Fier dhe Vlorë. Në rast përmbytjesh, të dhënat mbi shkallën e përmbytjes (sipërfaqja në ujë, kohëzgjatja, shkalla e dëmeve sipas kategorive të ndryshme të dëmit, etj.) grumbullohen në nivel prefekturë.

Ndërkohë, KKDM harton dhe mirëmban "Planet e gatishmërisë në rast emergjencash civile dhe Hartën e Përmbytjeve" e cila gjendet e botuar edhe në faqen e internetit të AKMC²⁷. Ndonëse duhet të theksojmë se planet e gatishmërisë së KKDM i referohen vetëm digave (të cilat lidhen kryesisht me veprat energjetike të vendit) dhe përmbytjeve që mund të shkaktohen prej tyre në rastet ekstreme të motit, ku kemi sasi të shtuar të reshjeve dhe prurje të mëdha të lumenjve.

6. Trajnim dhe certifikim i punonjësve që merren me ujitjen. Rehabilitimi dhe rritja e numrit të digave. Çfarë janë punimet rehabilituese në diga në tre vitet e fundit?

Në vendin tonë janë 650 diga në total, nga të cilat 362 janë diga të mëdha me lartësi mbi 15 metra. Përveç 5-6 digave të reja, shumica e digave janë mbi 30-40-vjeçare, të cilat kërkojnë mirëmbajtje, monitorim dhe një shfrytëzim të kujdesshëm. Shqipëria renditet ndër vendet e para në botë për nga numri i digave të mëdha/ për 1000 km^2 , si dhe për nga numri i digave të mëdha/ për 1 milion banorë, të ndara në dy grupe, diga që përdoren për prodhim hidro-energji dhe ato për bujqësi²⁸.

Raporti vjetor i KKDM për vitin 2020 thekson një sërë problematikash. Procesi i transferimit të shfrytëzimit, operimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të digave të mëdha prej 5 vitesh tashmë nuk ka sjellë përmirësime përse i përket shfrytëzimit, monitorimit dhe sigurisë së tyre. Ky proces në 90% të rasteve është kryer pa procesin e dorëzimit të dosjeve teknike të shfrytëzuesit të digave, pa trajnime për ekipin e inxhinierëve të digave, pa dorëzim të sistemeve të monitorimit të digave, si dhe pa instalim të asnjë sistemi alarmi apo përgatitje të hartave të përmbytjeve dhe planeve të gatishmërisë në rastet e emergjencave civile. Këto kërkesa përfaqësonin detyrime ligjore, të cilat MBZHR duhet t'i përmbushte, për zbatuar një proces korrekt, profesional dhe ligjzbatues.

Aktualisht, sipas informacioneve të KKDM, një pjesë e dosjeve teknike të projektit origjinal për digat e ujitjes ndodhen në arshivën e MBZHR. Sipas një informacioni paraprak të dërguar nga kjo arshivë, rezulton se numri i projekteve për digat e mëdha të ujitjes është jo më i madh se 50. Cilësia e këtyre projekteve është mjaft e dobët dhe kërkohet një

²⁶ <https://albcold.gov.al/>

²⁷ <https://albcold.gov.al/pgec-dhe-hartat-e-permbytjeve/>

²⁸ <https://fjala.al/2020/09/22/prezantohet-komiteti-kombetar-i-digave-te-medha-dhe-keshilli-teknik-flet-balluku/>

proces teknik për përgatitjen e vizatimeve teknike dhe dosjeve përkatëse, sipas standardeve teknike. Ky proces duhet të shoqërohet edhe me një proces trajnimi të ekipit teknik, përgjegjës për monitorimin dhe sigurinë e tyre²⁹.

7. Fuqizimi i strukturave për ndërhyrje dhe veprat e marrjes së ujit në shtratin e lumenjve - Si është situata me ndërhyrjet në shtratin e lumenjve?

Shqetësimi kryesor për cilësinë e ujit të baseneve lidhet me hidrocentralet (HEC-et). Vitet e fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të hidrocentraleve të vogla (SHPP) koncesionare të ndërtuara ose, që në plan për t'u ndërtuar në basenet ujore. Në nivel kombëtar, prej vitit 2008 janë dhënë 197 kontrata koncesioni për ndërtimin e 555 SHPP, nga të cilat 180 kontrata koncesioni janë aktive dhe ministria përfundoi 17 kontrata. Për 180 kontratat e koncesionit të cilat janë aktive, është parashikuar ndërtimi i 486 HEC-ve. Gjithashtu, në përputhje me implementimin e VKM-së nr. 822, ka akoma 119 HEC-e të cilat nuk janë subjekt koncesioni. Ka pasur studime (kur është kërkuar ligjërisht) p.sh mbi ndikimin që kanë SHPP-të në cilësinë e ujit të Basenit Ujor Drin–Bunë dhe jetën ujore. Megjithatë, mbeten ende shumë pyetje të hapura, në lidhje me vendndodhjen e SHPP-ve edhe ndikimin e tyre social dhe mjedisor në basenet ujore, që përfshijnë:

- ☞ Caktimin e vendeve, brenda ose në kufijtë e Zonave të Mbrojtura, apo ndërtimi duke respektuar tiparet arkitektonike dhe mjedisore;
- ☞ Rrjedhë e pamjaftueshme në shtratin e lumit, p.sh., potencial për të prishur standardet e rrjedhës ekologjike;
- ☞ Cilësia e raporteve të ndikimit në mjedis, ka të bëjë me mungesën e rishikimit të pavarur dhe disponueshmërinë e raporteve;
- ☞ Nevojën për vlerësime mjedisore dhe sociale nën marrëveshje huazimi specifike;
- ☞ Kompensimi i pronarëve të tokës dhe komuniteteve lokale të cilat preken nga mungesa e ujit apo nga përmbytjet;
- ☞ Ndikimi në erozionin e detit.

Për sa u përket efekteve të hidrocentraleve sipas legjislacionit për Natyrën të BE-së, Komisioni Evropian ka publikuar në vitin 2018 një dokument udhëzues³⁰. Dokumenti nënvizon rangun e efekteve që hidrocentralet mund të kenë në habitatet dhe speciet nën DKU-në dhe nën Direktivat e Natyrës, veçanërisht, të tilla si:

- ☞ Ndryshimet në morfologjinë e lumit dhe të habitateve lumore;
- ☞ Barriera për migrimin dhe shpërndarjen e specieve të mbrojtura;
- ☞ Ndërprerjen e dinamikës së sedimenteve;
- ☞ Ndryshimin e regjimit të rrjedhës ekologjike;
- ☞ Ndryshimet e regjimit të rrjedhës, sepse e marrin hidrocentralet;
- ☞ Ndryshimet në ciklet e përmbytjeve sezonale;
- ☞ Lëndët kimike në ujë ose ndryshimet në temperaturë;
- ☞ Plagosja dhe vrasja e kafshëve individuale;
- ☞ Zhvendosja edhe shqetësimi;
- ☞ Efektet në speciet dhe habitatet tokësore.

²⁹ <http://albcold.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/1-Raporti-vjetor-2020-per-digat-dhe-dambat.pdf>

³⁰ https://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/management/docs/hydro_final_june_2018_en.pdf

Përqasja tradicionale për zhvillimin e një plani ose projekti, qoftë ky për hidrocentrale ose fusha të tjera, është që së pari të konceptohet plani ose projekti për qëllimin e tij dhe më pas të konsiderohet mjedisi i gjerë dhe çështje të tjera. Megjithatë, kjo shpesh shoqërohet me konflikte po të marrim në konsideratë vonesat që lidhen me procesin e planifikimit, të cilat ngushtojnë kohën për të manovruar. Ndërsa projektimi ka avancuar, vlerësimi i ndikimit në mjedis shpesh kthehet në një ushtrim për kufizim dëmsh. Pranimi i këtyre vështirësive, bën që planifikuesit e infrastrukturës gjithnjë e më shumë të ndjekin një përjasje të integruar të planifikimit dhe projektimit të veprës. Përjasja e integruar merr në konsideratë edhe nevojat infrastrukturore ashtu edhe ato ekologjike të vendndodhjes dhe i faktorizon këto në konceptimin fillestar të projektit, së bashku me përdorues të tjerë të lumit. Ndërtimi i hidrocentraleve të vogla, për të zvogëluar nevojat e vendit për energji elektrike, ka krijuar përgjithësisht presion të konsiderueshëm në rrjedhat ujore dhe veçanërisht tek ekosistemet, por edhe në jetën e komuniteteve ku ngrihen këto HEC-e, pasi ka pasur shumë konflikte midis banorëve dhe ndërtuesve, të cilët në shumicën e rasteve as nuk janë pyetur. Në këto kushte, është me rëndësi të vëzhgohen procedurat dhe veçanërisht ligjet dhe rregullat që kanë lidhje me menaxhimin dhe përdorimin e ujit në basenet ujore.

Gjatë procedurave të dhënies së lejeve, jo në të gjitha rastet, vlerësimi i rrjedhës ekologjike bëhet duke marrë parasysh përdoruesit e tjerë të rrjedhës së poshtme të hidrocentralit të vogël. Disa herë përdorues të caktuar neglizhohen, veçanërisht përdoruesit e sektorit të bujqësisë, që kanë lidhje me ujitjen.

Ndërtimi i kapaciteteve të Zyrës së Administrimit të Baseneve Ujore (ZABU) është një e domosdoshmëri, jo vetëm për të kuptuar dhe interpretuar elementet hidrologjike të rrjedhës, por gjithashtu për të lidhur ato me mundësitë për përdorim të ujit dhe nevojat për rrjedhë ekologjike, e cila është e domosdoshme për një mjedis të qëndrueshëm ekologjik në kohë edhe hapësirë. Këto zyra duhet të jenë në gjendje të bëjnë një vlerësim të përgjithshëm të balancës së ujit në seksionet e rrjedhës ujore në sezona të ndryshme të vitit, në mënyrë që të vlerësojnë siç duhet kërkesën për ujë dhe furnizimin me ujë, duke mbajtur në mënyrë të përhershme rrjedhën ekologjike e cila është e nevojshme për mjedisin në përgjithësi dhe detyruese për të siguruar statusin ekologjik të rrjedhës në vetvete, në përputhje me ligjin 111/2012, "Për menaxhim e integruar të burimeve ujore".

Në këtë kuptim, aktualisht rrjeti i pamjaftueshëm i monitorimit, të dhënat e kufizuara (mungesa e miratimit/ vlefshmërisë) së bashku me kapacitetin e limituar teknik dhe financiar e bëjnë shumë të vështirë zbatimin e ligjit.

Veprimi Prioritar 9: Përshtatja në sektorin bujqësor

Ministria përgjegjëse: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

1. Infrastrukturë mbrojtëse në ferma dhe mënyra alternative lidhur me sistemet e përdorura nga fermerët (sera, tunele bimorë, barriera bimorë, sisteme të mbrojtjes nga breshëri). A ka investime publike apo private në këtë drejtim?

Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural (MBZHR) ka dhënë mbështetjen e saj përmes programeve të AZHBR, qoftë përmes skemës kombëtare të financimit në bletari, ferma organike, sera, bimë mjekësore dhe blegtori. Thirrjet për prioritetet dhe kufijtë e financimit

botohen në faqen e internetit të AZHBR³¹ çdo vit. Niveli i financimit prej fondeve të buxhetit të shtetit është në masën prej 25% dhe pjesa tjetër prej programit IPARD.

Programi IPARD 2014-2020, ka vijuar financimin edhe gjatë viteve 2019-2020 me katër thirrje:

- ✓ **Thirrja e parë** - për makineri bujqësore janë projekte të zbatuara në vitin 2019-2020. Shifra e financimit: 5.200.000.000 Lekë ose ekuivalent 41.200.000 Euro;
- ✓ **Thirrja e dytë** - për diversifikimin e fermës, agro-përpunimin dhe investime fizike janë projekte të zbatuara në vitin 2020-2021. Shifra e financimit: 6.400.000.000 Lekë ose ekuivalent 53.300.000 Euro;
- ✓ **Thirrja e tretë** - për agro-përpunimin dhe investime fizike janë projekte të zbatuara në vitin 2021-2022. Shifra e financimit: 3.150.000.000 Lekë ose ekuivalent 26.000.000 Euro;
- ✓ **Thirrja e katërt** - për diversifikimin e fermës. Në këto mbështetje janë përfshirë edhe sistemet e mbrojtjes që do të hapen gjatë vitit 2022.

Por ritheksojmë se niveli i financimit për klimën në këto programe mbetet i pamundur për t'u vlerësuar.

2. Teknologji bujqësore, varietete farërash me aftësi të lartë përshtatëse ndaj klimës. Cilat janë teknologjitë e reja, të prezantuara në sektor gjatë këtyre tre viteve të fundit?

Informacioni për këtë masë është i kufizuar ose shumë i shpërndarë në projekte të veçanta të skemës kombëtare të mbështetjes, ndaj mund të themi se nuk ka një program të mirëfilltë që të mbështesë teknologji të reja bujqësore, apo varietete farërash të përshtatura ndaj ndryshimeve klimatike. Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) ka mbështetur një program që synon vlerësimin e varieteteve autoktone të bimëve, i cili do të vijojë edhe gjatë vitit 2022.

Disa programe kërkimore janë ndërmarrë nga Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve (IRGJB)³², si njësi kryesore e Universitetit Bujqësor të Tiranës, i cili është institucion kombëtar që koordinon aktivitetet në fushën e ruajtjes dhe menaxhimit të Resurseve Gjenetike Bimore (RGJB). IRGJB është një institucion relativisht i ri, i ngritur prej ristrukturimit të Qendrës së Resurseve Gjenetike, ku operon dhe Banka Gjenetike Kombëtare. Qëllimi i tyre është promovimi i ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të Resurseve Gjenetike të Bimëve për Ushqimin dhe Bujqësinë (RGJBUB) në Shqipëri.

3. A ka informacion programatik (të dhëna hidrometeorologjike dhe gjeo-hapësinore në mbështetje të fermerëve?

IGJEO bën botimin e Buletineve Klimatike mujore të cilat janë të botuara në faqen e institucionit.³³

Të dhënat për vendin referohen përmes 24 stacionesh dhe paraqiten në formën e grafikëve dhe hartave, në dokument pdf. Vlerësimi lidhur me dobini e këtyre të dhënave për fermerët duhet kryer me kujdes për t'i bërë këto të fundit më lehtësisht të përdorshme,

³¹ <http://www.azhbr.gov.al/skema-kombetare/>

³² <http://qrgj.org/>

³³ <https://www.geo.edu.al/newweb/?fq=brenda&gj=gj1&kid=42>

veçanërisht për sa i përket planifikimit të ndërhyrjeve apo llojit të varieteteve që mund të kultivohen për kushtet klimatike të krijuara.

4. Ngritja e mjediseve të standardizuara për blegtorinë, mbajtja nën kontroll e përhapjes së sëmundjeve nga makro parazitët. Çfarë janë masat e ndërmarra në uljen e sëmundshmërisë ndaj parazitëve?

Për periudhën e monitorimit 2019-2021 janë referuar disa programe të mbështetjes për MBZHR ofruar nga FAO, ku përfshihet edhe hartimi i Planit të Veprimit për Mbrojtjen e Bimëve 2022-2030, i cili është akoma në proces hartimi. Një program tjetër i mbështetjes për rritjen e kapaciteteve ka synuar trajnimin e specialistëve në menaxhimin e integruar të dëmtonjësve të bimëve, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga të gjitha nivelet e institucioneve qendrore deri tek fermerët. Megjithatë vlen të theksohet se mungon një bazë e plotë të dhënash mbi ndërhyrjet në këtë masë.

4.5 Vlerësimi i masave për sektorin e menaxhimit të ujërave

Veprimi Prioritar 8: Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore

Agjencia përgjegjëse: Agjencia e Menaxhimit të Baseneve Ujore

1. Planet e menaxhimit të baseneve me Kuadrin e Instrumentit Ndihmës për Para-anëtarësim (IPA). PKV parashikon hartimin e katër planeve për menaxhimin e baseneve lumore Vjosë, Mat, Shkumbin dhe Seman. A ka pasur zhvillime në këtë drejtim?

Ndonëse SKNK është miratuar pas ngritjes së AMBU, masat i takojnë periudhës deri në vitin 2017. Ngritja dhe funksionimi i AMBU, mundësoi një ecuri më të shpejtë të hartimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujëmbledhës. Detyrimi për këto plane, vjen prej përmbushjes së detyrimeve në kuadër të transpozimit dhe zbatimit të Direktivës Kuadër për Ujin, që ka qenë edhe shtysa kryesore për një ecuri më të mirë në zbatimin e kësaj mase. Nga shtatë basenet lumore në Shqipëri, deri më tani janë hartuar pesë Plane të Menaxhimit të Baseneve Lumore (PMBL) për lumenjtë Seman, Ishëm-Erzen, Drini-Buna³⁴, Mati dhe Shkumbin. Lumi Vjosa nuk ka ende një plan menaxhimi. Gjatë 2022, AMBU ka planifikuar hartimin e një dokumenti vlerësues të nevojave, që do të përbëjë edhe bazën kryesore për hartimin në vitin e ardhshëm të planit të menaxhimit për këtë lumë.

Përgatitja e Planit për Menaxhimin e Baseneve Ujore (PMBU) është kryer me mbështetjen financiare të BE ose fondeve bilaterale. Kështu, Plani i Menaxhimit për Basenin Ujor Drin-Bunë është pjesë e mbështetjes institucionale të komponentit të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (MIBU) të Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes në Shqipëri (PBUU). PBUU-ja financohet nga Banka Botërore, Agjencia Suedeze për Zhvillim të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (Sida) dhe Qeveria Shqiptare, dhe është krijuar për të hedhur themelet për menaxhim më racional dhe më të përgjegjshëm të burimeve ujore. Ndërsa planet e tjera

³⁴ VKM 849, dt. 04.11.2020 për miratimin e Planit të Menaxhimit të basenit ujor Drin-Bunë

të menaxhimit janë mbështetur nga një projekt i financuar nga BE, të zbatuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA).

Ndërsa Shqipëria po ecën drejt anëtarësimit në BE, kuadri ligjor dhe institucional dhe baza e njohurive për adresimin e përgatitjes, planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave janë në zhvillim të vazhdueshëm, me synim përgjegjësi të qarta dhe transparencë në zbatimin e *Acquis*-së së BE-së. Transpozimi i plotë i direktivave përkatëse të BE-së ende nuk është arritur. Legjislacioni dhe rregulloret për menaxhimin e ujërave ndahen në katër seksione kryesore: legjislacioni primar, legjislacioni sekondar, legjislacioni ndërsektorial dhe direktivat e BE-së.

Është e qartë se zbatimi efektiv i Direktivës Kuadër të Ujit (DKU), siç kërkohet sipas ligjit evropian, nuk është plotësisht i mundur në asnjë prej baseneve ujore në Shqipëri. Zbatimi efektiv i DKU-së kërkon zhvillim të mëtejshëm të kapaciteteve qendrore dhe rajonale për të përmbushur kërkesat specifike të DKU-së, edhe pse të detajuara në ligjet kombëtare dhe të pasqyruara në strukturën institucionale, e cila barazohet me një qëllim serioz për zbatimin e DKU-së në të ardhmen. Shqipëria aktualisht nuk ka kapacitetin teknik për të kryer kërkesat specifike të DKU-së. Planifikimi i Basenit Ujor ka përfshirë gjithashtu zhvillimin e një modeli të përshtatshëm të basenit ujor si një mjet për vlerësimin e skenarëve të ndryshëm për zhvillimin e burimeve. Aspektet e cilësisë së ujit kanë marrë vëmendje të madhe në plane, pasi përkeqësimi i cilësisë së ujit është një shqetësim në rritje.

Ka përparim në punën e AMBU-së, e cila po punon për hartimin e standardeve për Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore, sipas kërkesave të Direktivës. Faza e parë e këtyre planeve do të jetë 2022-2027, për t'u harmonizuar me fazën e dytë të zbatimit të Direktivës.

Megjithëse Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) ka përparim në zhvillimin e metodologjisë, e cila është miratuar vetëm në fund të vitit 2020 me VKM nga qeveria, për ta bërë procedurë të detyrueshme ligjore për zbatim të mëtejshëm në të shtatë basenet lumore të Shqipërisë. Ka përparim në zhvillimin e PMBL-ve përmes një procesi të hollësishëm të analizave të të dhënave dhe duke përfshirë shumë nga fushat tematike të kërkuara nga Direktiva. Sidoqoftë, përcaktimi i zonave të ndjeshme brenda secilës PMBL mbetet një çështje që ndikon në mbrojtjen dhe masat e ruajtjes së tyre. Ekspertët e mjedisit dhe përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) kanë shprehur urgjencën për krijimin e zonave të ndjeshme brenda secilit basen lumor, në mënyrë që të përcaktohen masat e ruajtjes dhe mbrojtjes së natyrës, së habitateve dhe për rregullimin e përdorimit të ujit. Sidoqoftë, progresi i ngadaltë në zhvillimin e planeve po dëmton disa nga lumenjtë, ku ndryshimi intensiv i habitateve po ndodh për shkak të nxjerrjes së zhavorrit dhe ndërtimit të HEC-ve. Komuniteti i OSHC-ve mbetet i shqetësuar për mungesën e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) të duhura të kryera për më shumë se 530 njësi të vogla hidro-energjetike të planifikuara, në ndërtim ose në veprim në të gjithë vendin.

Instrumentet dhe institucionet e monitorimit të cilësisë së ujit duhet të sqarohen në mënyrë institucionale, duke përfshirë kapacitetet dhe burimet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Një plan i monitorimit të cilësisë së ujit duhet të ekzistojë dhe të ndiqet në mënyrë rigoroze për parametrat e kërkuar. Paqartësia e përgjegjësisë në lidhje me monitorimin e cilësisë së ujit: sipas ligjit AKM-ja është institucioni përgjegjës, megjithëse AMBU-ja po kërkon që

të ketë përgjegjësi mbi cilësinë e ujit. Duke marrë parasysh burimet e nevojshme për këtë proces dhe fondin aktual të alokuar, një lëvizje e tillë e Monitorimit të Cilësisë së Ujit tek AMBU-ja nuk do të garantojë as efikasitet në optimizimin e burimeve, as adresimin e problemit të monitorimit të pamjaftueshëm në planin afatshkurtër. Këshilli i Ujit në nivelin rajonal duhet të ketë fushëveprim më të gjerë të përgjegjësive të menaxhimit të ujit, në vend që vetëm të japë leje për përdorimin e ujit, të cilat bëhen të parregulluara për shkak të mungesës së Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore. Roli aktiv duhet të konsistojë në adresimin e pikave të nxehta të ndotjes përgjatë trupave ujorë dhe drejtimin e veprimeve në nivel vendor dhe rajonal për të parandaluar erozionin, ndotjen dhe çdo veprimtari të paligjshme që ndikojnë në cilësinë e ujit.

Procesi i planifikimit të basenit ujor propozon sqarime rreth efektivitetit të strukturës aktuale të menaxhimit të ujit dhe përshkruan mandatin e ardhshëm të institucioneve të menaxhimit siç kërkohet nga nevojat e menaxhimit të basenit në tërësi. Në përgjithësi, kapacitetet administrative për menaxhimin e ujit janë të dobëta dhe të pamjaftueshme. Është fakt, që duhet të merret parasysh se gratë në zonat rurale në Shqipëri shpesh përjashtohen nga proceset vendimmarrëse në lidhje me menaxhimin në përgjithësi, edhe pse punojnë dhe menaxhojnë burimet së bashku me burrat. Gjithashtu, të rinjtë priren të përjashtohen nga vendimet, dhe veçanërisht gratë e reja. Kjo kulturë shoqëron gratë dhe burrat së bashku, por që çon në vendimmarrje më pak të diskutuara që nuk marrin parasysh përparësitë e grave, nevojat ose p.sh. idetë e biznesit etj.

Zhvillimet më të rëndësishme ligjore për këtë sektor përfshijnë:

- **Korrik 2019:** Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 6, datë 12.6.2019: Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor;
- **Dhjetor 2020:** Vendim Nr. 1122, datë 30.12.2020: Për miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e kadastrës kombëtare të burimeve ujore;
- **Dhjetor 2020:** Vendim Nr. 1015, date 16.12.2020: Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbajtjet.

2. A është punuar në përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore për shpërndarjen e ujit?

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 221 datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore". Misioni i agjencisë është mirëqeverisja e burimeve ujore me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve dhe nxituri konkurrueshmërinë e përdorimit dhe prioritarizimin e përfitueshmërisë ekonomike.

Krijimi i kësaj agjencie i ka dhënë një vullt hartimit të akteve ligjore dhe dokumenteve të tjerë strategjikë për ujin. Ndërmjet tyre, Ligji për menaxhimin e ujit (2012, i ndryshuar) është duke u rishikuar dhe planifikuar për të kaluar në diskutim gjatë vitit 2022. Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (2017), hartuar nga MBZHR, nuk ka pësuar ndonjë ndryshim ose vlerësim gjatë periudhës në shqyrtim (2019-2021). Gjithashtu, Enti Rregullator i Ujit (ERRU) mbetet enti rregullator i vetëm që ka mision të sigurojë se ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve japin cilësinë më të

mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht për të gjithë konsumatorët në Shqipëri.

Në kuadër të punës së këtij institucioni, ka një sërë vendimesh që lidhen me menaxhimin e ujit të pijshëm dhe të ujërave të përdorur, përfshirë edhe elemente të monitorimit të performancës së kompanive që ofrojnë këtë shërbim. Mund të theksojmë, se këto akte kanë pak, apo aspak lidhje me masat përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike, ndonëse trajtojnë një ndër burimet natyrore që ka ndikim të drejtpërdrejtë në sasinë e ujit të disponueshëm për popullatën dhe cilësinë e shërbimit të ofruar.

Shpërndarja e legjislacionit të miratuar për ujin, gjatë periudhës 2019 – 2021 ka këta tregues.

Viti	Vendime të ERRU	VKM	Udhëzim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë	Rezolutë e Kuvendit
2019	24	2	1	1
2020	6	4	1	1
2021	18	-	-	-

4.6 Vlerësimi i masave për territorin, infrastrukturën dhe energjinë

Veprimi Prioritar 11: Plan i integruar ndërsektorial për zonën e bregdetit

Ministria përgjegjëse: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

1. Përforsimi i legjislacionit lidhur me ndërtimet në zonën bregdetare. Çfarë kanë qenë zhvillimet e fundit ligjore që lidhen me ndërtimet në zonën bregdetare?

Ndonëse zona bregdetare e vendit vlerësohet e rëndësishme së veçantë, përse i përket aspekteve zhvillimore është në të njëjtën kohë edhe më e prekura nga ndikimi që krijojnë ndryshimet klimatike, mund të thuhet se deri më tani nuk ka pasur zhvillime ligjore të veçanta që të forcojnë kriteret ndaj ndërtimeve në bregdet. Gjatë kësaj periudhe ka pasur një sërë ndërhyrjesh prej Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit (IKMT), për shkatërrimin e ndërtimeve të paligjshme në funksion të mbrojtjes së territorit, por që nuk vlerësohen të lidhura me masat përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike.

2. Zhvillim kapacitetesh në bashkitë e zonave bregdetare. A janë zhvilluar veprimtari të njohjes së punonjësve vendorë me çështjet e klimës gjatë (2019-2021)?

Gjatë periudhës së monitoruar nuk është identifikuar ndonjë program i veçantë, që ka si objektiv kryesor zhvillimin e kapaciteteve të autoriteteve vendore për ndryshimet klimatike. Megjithatë një numër i madh projektsh që janë në zbatim në njësi vendore pilote si në Lezhë, Durrës, Vlorë dhe Orikum, kanë përfshirë aktivitete trajnuese dhe ndërgjegjësuere për ndryshimet klimatike. Përgjithësisht këto aktivitete janë kryer në kuadër të zbatimit të programeve të financuara prej burimeve të asistencës së huaj për Shqipërinë dhe të zbatuara prej GIZ, PNUD, UNEP, dhe OJF-të kombëtare dhe vendore, etj.

3. Projekte pilot me rëndësi për ndryshimet klimatike. Cilat janë projektet pilote të zhvilluara në nivel bashkish në tre vitet e fundit? Ç'pjesë e tyre ka lidhje me parandalimin dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike?

Gjatë procesit të monitorimit janë referuar një numër projektsh të zbatuara në nivel vendor, por përgjithësisht përbëjnë komponentë të programeve më të mëdha, ku një numër i kufizuar njësisish vendore zgjidhen për pilotimin e ndërhyrjeve dhe kanë ndikim mbi klimën.

GIZ po zbaton një projekt “Punë për komunitetin” si pjesë e një ndërhyrjeje afatgjatë për të zbutur efektet e klimës përmes përshtatjes ndaj këtyre dukurive natyrore dhe njëkohësisht duke përgatitur qeverinë qendrore dhe vendore për të paralajmëruar situatën e përmblytjeve në basenin e Drinit. Për shkak të efekteve të ndryshme që ka dhënë pandemia në të gjithë globin, qeveria gjermane ka ardhur me një alternativë mbështetjeje që sjell bashkë të dyja:

- ✓ Masat përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike;
- ✓ Ndihmën ekonomike për personat apo familjet të cilat janë të ndikuara negativisht nga efektet e pandemisë.

Nisma ka mbështetur me një financim më të madh në vitin 2021 për bashkitë më të prekura nga përmblytjet si: Bashkinë Shkodër, Fier, Dimal, Berat, Elbasan dhe Tepelenë. Ndërkohë në Zonat e Mbrojtura është punuar për pastrimin e kanaleve kulluese, në mënyrë që uji që vjen nga përmblytjet të largohet sa më shpejt dhe të krijojë ndikim sa më të vogël në tokat bujqësore. Në vitin 2018 janë punësuar 265 individë dhe fushata është ripërsëritur në vitin 2020 me 370 individë; ndërsa në vitin 2021 janë punësuar 811 individë duke injektuar në ekonomi gati 1.200.000 Euro, jo vetëm për punësimin e tyre, por edhe për pajisje për bashkitë përfituese. Ndikimi në komunitet ka qenë pastrimi këtë vit i rreth 286 km kanale kulluese, që i shërbejnë 7 800 ha tokë bujqësore. Në vitin 2021 janë mbjellë rreth 31 800 fidanë.

4.7 Vlerësimi i masave për shëndetësinë

Veprimi Prioritar 10: Nxitja e zbatimit të strategjisë së përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e shëndetësisë

Ministria përgjegjëse: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

1. A ka pasur fushata informuese dhe a është bërë në kohën e duhur informimi i komunitetit mbi valët e të nxehtit?

Ndonëse nuk është gjetur ndonjë program i mirëfilltë, ndërgjegjësimi publik mbi valët e të nxehtit, mund të referohet se gjatë periudhës së verës në korrik 2021 kur edhe vala e të nxehtit ishte më e madhe, Ministria e Shëndetësisë dhe Përkrahjes Sociale me anë të drejtorive të Shëndetit Publik në qarqet më të prekura të vendit, ndërmori një varg masash për të informuar popullatën mbi rrezikun dhe shmangien e pasojave që krijon i nxehti. Këto fushata në qytetet bregdetare dhe të ultësirës perëndimore si Lezhë, Durrës, Vlorë, Sarandë etj., përmbanin shpërndarjen e mjeteve informuese për banorët apo turistët në periudhat më të nxehta të ditës.

Më tej, bashkitë e mëdha të vendit si Tirana, në bashkëpunim me organet e shëndetësisë vijuan me hapjen e qendrave të freskimit me ujë apo hijëzim.

2. Përshtatja me ndryshimet e klimës në shëndetësi. A ka ndonjë politikë të përshtatjes me NK për këtë sektor, hartimi i të cilës është zhvilluar në këto tre vite?

Gjatë periudhës së monitorimit nuk është identifikuar ndonjë masë e veçantë përshtatëse ndaj valëve të të nxehtit.

3. A ka mbështetje me trajnime dhe informim për Drejtoria e Shëndetit Publik (DSHP) dhe bashkitë, në përshtatjen e sistemeve ekzistuese të mbikëqyrjes për sëmundjet vektoriale?

Instituti i Shëndetit Publik, me anë të Departamentit të Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive, është institucioni qendror përgjegjës për monitorimin në vijimësi të Zoonozave³⁵ dhe Sëmundjeve që Transmetohen nga vektorët. Deri në periudhën e para-pandemisë COVID-19, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) ka raportuar në mënyrë periodike “Alertet” dhe përditësimet lidhur me vëzhgimin e sëmundjeve infektive³⁶.

4. Rritja e kapaciteteve të ISHP me laboratorë entomologjike dhe kërkime në këtë fushë. Çfarë janë kapacitetet e ISHP-së në infrastrukturë për sëmundjet vektoriale? Cila pjesë e tyre janë investim i kohëve të fundit?

ISHP ka laboratorë të dedikuar dhe personel të kualifikuar në fushën e entomologjisë dhe sëmundjeve vektoriale, që mbulojnë me vëzhgime të përgjithshme dhe të posaçme varësisht nevojave dhe dinamikave në vend.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 ka ndryshuar prioritetet për mbështetjen në këtë fushë, ndaj ka qenë e pamundur identifikimi i projekteve të veçantë për këtë masë.

4.8 Vlerësimi i masave në nivelin vendor

Veprimi Prioritar 12: Nisma për krijimin e planeve të përshtatjes në nivel bashkie

Ministria përgjegjëse: Ministria e Brendshme

1. A ka plane të përshtatjes ndaj NK në nivel bashkie? Si i vlerësoni ato?

Plani i përshtatjes me NK në nivel vendor është një proces që nuk ka filluar ende. Aktualisht nuk ka plane të zhvilluara në asnjë bashki të vendit. Hartimi i tyre pritet të marrë jetë me fillimin e punës së projektit ‘Readiness’ të PNUD-it në Tiranë, i cili parashikon zhvillimin e këtyre planeve në 8 bashki pilot të vendit.

Në periudhën e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike kjo masë ka qenë përgjegjësi e Ministrisë së Zhvillimit Urban, e cila është shkruar dhe funksionet e saj kanë kaluar në Ministrinë e Brendshme.

Veprimi Prioritar 14: Rritja e nivelit të gatishmërisë së mbrojtjes civile dhe zvogëlimit të riskut të fatkeqësive natyrore

³⁵ Zoonozat janë sëmundje të shkaktuara nga mikrobet që kalohen midis kafshëve dhe njerëzve.

³⁶ <http://www.ishp.gov.al/departamenti-i-kontrollit-te-semundjeve-infektive/zoonozat-dhe-semundjet-qe-transmetohen-nga-vektoret/>

Institucioni Përgjegjës: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)³⁷ është pjesë përbërëse e strukturës së Ministrisë së Mbrojtjes. AKMC është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 45, datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile”; VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”; si dhe Urdhri i Kryeministrit nr. 27, datë 3.2.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, si strukturë përgjegjëse për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

1. Zhvillimi i një harte rajonale për rreziqet e përmbytjes sipas direktivës së BE-së. A kemi një hartë rajonale të përmbytjeve sipas direktivës së BE?

Sikundër është përmendur, harta e përmbytjeve është hartuar prej Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, si pjesë e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC). Hartat gjenden në nivel prefekturë për ato prefektura që janë të prekura nga përmbytjet e lumenjve.

Direktiva e BE-së për përmbytjet nuk është transpozuar ende. Fillimi i punës për këtë proces transpozimi është vlerësuar si prioritet për vendin, që duhet të adresohet menjëherë.

2. Sistem i paralajmërimit të hershëm për përmbytjet dhe shkëmbimi i të dhënave me Sistemin Evropian të Ndërgjegjësimit për përmbytjet (EFAS). A kemi një sistem të paralajmërimit të hershëm nga përmbytjet, në linjë me EFAS?

Sistemi i paralajmërimit të hershëm i instaluar pranë IGJEO, me ndihmën e mbështetjes së huaj (projekt i GIZ) ka mbuluar fillimisht rajonin e lumit Drin, duke përfshirë edhe të dhëna në nivel rajonal (Kosovë dhe Mali i Zi) dhe instalimin e 13 stacioneve të monitorimit. Më tej, projekti PRONEWS i financuar nga BE për Agjencinë e Mbrojtjes Civile, ka pasur një komponent të veçantë të modernizimit dhe vënies në funksionin të stacioneve të monitorimit nga përmbytjet, i cili ka përfunduar në shtator 2021. Qëllimi i kësaj mbështetjeje ishte përafrimi i sistemit të paralajmërimit me EFA-s, por ende nuk ka një raport vlerësimi për këtë projekt të përfunduar rishtazi.

Mirëmbajtja e dobët dhe dëmtimi gjatë 30 viteve të fundit, sjellë uljen e kapaciteteve monitoruese dhe cilësi më të dobët të të dhënave.

3. A kryhet ndërgjegjësim i publikut për rreziqet ndaj përmbytjeve?

Aktivitetet ndërgjegjësuere kanë qenë pjesë e projekteve më të mëdha si PRONEWS, GIZ, etj si ndërgjegjësimi i komuniteteve vendore në Shkodër dhe Vlorë përmes ditëve të veçanta (maj dhe tetor 2019) me aktivitete njohëse dhe ndërgjegjësuere në sheshet e qytete ku është demonstruar reagimi i duhur prej banorëve, i ndërhyrjes së shpejtë dhe urgjencës shëndetësore në raste përmbytjesh. Aktivitetet janë drejtuar nga Agjencia e Mbrojtjes Civile.

4. Anëtarësimi i Shqipërisë në Mekanizmin e BE për Mbrojtjen Civile (EUCPM). A është Shqipëria anëtare e EUCPM?

³⁷ <https://www.mod.gov.al/index.php/ministria/strukturat-vartese/akmc>

Programi PRONEWS, i përfunduar në shtator 2021 kishte si qëllim edhe asistencën për anëtarësimin në EUCPM. Ende nuk ka informacion mbi progresin në këtë drejtim.

5. A ka rritje të kapaciteteve të IGJEO (ish-IGJEUM) mbi ofrimin e shërbimeve?

IGJEO, si aktor i rëndësishëm, është partner përfitues në të gjitha projektet e rëndësishme të lidhura me klimën. Nuk ka një bazë të dhënash mbi numrin trajnimeve dhe rritjen e kapaciteteve të stafit, përveç të dhënave sporadike të mbledhura prej programeve të veçantë.

6. A ka rritje të rolit të task forcës për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në nivel qarku?

Nuk ka zhvillime në këtë drejtim.

V. GJETJE KRYESORE

Shqipëria është renditur në nivel global krah vendeve që bëjnë përpjekje për të zvogëluar shkarkimet dhe marrë masa për tu përshtatur me ndryshimet klimatike. Ndonëse nuk ka detyrime për uljen e shkarkimeve të gazeve serë, kontributi i vendit tonë është artikuluar prej niveleve më të larta politike në ngjarje të rëndësishme globale siç ishte Konferenca e Palëve të KKKNK në Glasgow (nëntor 2021).

Është e qartë se vendi ynë preket ndjeshëm prej ndryshimeve klimatike. Ndërgjegjësimi për këtë rrezik të lartë është rritur gradualisht, duke u materializuar në nisma të reja ligjore siç ishte: miratimi i Ligjit për Ndryshimet Klimatike (2020), zbatimi i programeve përshtatëse, fuqizimi i kapaciteteve dhe aktiviteteve ndërgjegjëse dhe të përfshirjes së komuniteteve.

Periodha e monitoruar ka përkuar me një sërë ngjarjesh të rëndësishme si tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia COVID-19. Megjithatë, diskutimi për klimën gjatë vitit 2021 ishte në vëmendjen e publikut dhe të vendimmarrësve përkrah sfidave të tjera të periudhës. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të SKNK nxjerr në pah një sërë gjetjesh të rëndësishme:

Gjetje të përgjithshme

1. Plan i Veprimit është i orientuar vetëm si plan i veprimeve prioritare të përshtatjes.

Plan i masave zbutëse nuk është i përfshirë në Planin e Veprimit. KKP (2016) ku është bazuar hartimi i SKNK ka pasur të përfshirë vetëm masat zbutëse, të cilat nuk janë përfshirë në SKNK. Ndërkohë KKP e rishikuar (2021) ka renditur planin e masave të zbutjes dhe masat përshtatëse. Objektivi i vendit për të ulur 20.9% të shkarkimeve deri në 2030, kërkon përfshirjen e këtyre masave edhe në dokumentin strategjik të vendit, pra në SKNK, të rishikuar.

2. Plan i Veprimit përmban masat përshtatëse të cilat janë identifikuar në një periudhë kohore të largët, që ose kanë qenë të tejkaluara në kohë ose kanë pasur nevojën e rishikimit në momentin e miratimit të SKNK. Shfazimi në kohë i veprimeve prioritare përshtatëse krijon konfuzion për monitorimin e realizimit të tyre, duke i kthyer ato shpesh në masa parazite dhe të palidhura me nevojat aktuale të periudhës që mbulon SKNK.

3. Mungesa e krijimit të instrumenteve të monitorimit edhe tre vjet pas miratimit të strategjisë, por me gjasë edhe për disa vite të tjerë në vijim, pamundëson vlerësimin e ecurisë për zbatimin e Planit të Veprimit në tërësi apo edhe të masave të veçanta të tij. Kjo masë e vlerësuar si veprim prioritar afat shkurtër është domosdoshmëri e procesit për monitorimin dhe rishikimin periodik të planit me qëllim rishikimin e tij në bazë të ecurisë dhe nevojave të vendit.

4. Grupi Ndërmintor për Ndryshimet Klimatike si organi koordinues ndërqeveritar nuk ka funksionuar. Mungesa e një strukture të tillë koordinuese çon në fragmentarizimin e ndërhyrjeve. Mungesa e shkëmbimit të informacionit mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve në institucione të ndryshme, i bën kaotike ndërhyrjet, ose të palidhura në funksion të përshtatjes me ndikimet e klimës. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mbetet institucioni që ka përgjegjësinë e institucioneve për proceset ligjore dhe strategjike për klimën, por komunikimi ndërinstitucional në nivelin teknik ka qenë i pamjaftueshëm (shpesh herë *ad-hock*) për të mundësuar procese të harmonizuara dhe efëcente.

Gjetje të veçanta

5. Gjatë periudhës tre vjeçare të zbatimit të Planit Kombëtar të Përshtatjes 2019-2021, vërehet **ecuri me shpejtësi të ndryshme në zbatimin e masave të renditura si prioritare**. Në disa veprime prioritare është raportuar se nuk ka pasur zhvillime. Mungesa e reflektimit dhe vlerësimit mbi mungesën e progresit për këto masa pamundëson edhe analizën mbi shkaqet.

6. **Veprimet Prioritare (VP) të grupit të parë (Veprime Prioritare 1 – 6)** që përbëjnë drejtime më të përgjithshme që mbulojnë fushat e zhvillimit institucional, ligjor dhe financiar për klimën, **paraqesin ecuri të pamjaftueshme në zbatimin e tyre**. Ndonëse ecuria e plotësimit të kuadrit ligjor është përshpejtuar gjatë viteve 2020-2021, lidhur me masat përshtatëse procesi ka qenë i ngadaltë. Fokusi kryesor është dhënë në masat zbutëse (të cilat nuk janë pjesë e planit të veprimit në SKNK), përfshirë kuadrin ligjor për energjinë, ndërkohë që planifikimi i masave përshtatëse nuk ka pasur ndonjë proces vlerësimi; rishikim të veprimeve. Gjatë kësaj periudhe, fokusi kryesor ka qenë adresimi i nevojave të vendit lidhur me ngritjen e kapaciteteve për këtë proces.

- Ndonëse njihet roli drejtues i MTM, nuk ka pasur zhvillime institucionale lidhur me drejtimin e proceseve përshtatëse. (VP. 1) **Nuk ka pasur asnjë zhvillim lidhur me ndërtimin e instrumenteve përshtatëse** për Ndryshimet Klimatike si “Thjerra Klimatike; Qëndrueshmëria Klimatike; Vlerësimi Strategjik Mjedisor, me ndjeshmëri klimatike; Treguesit e shpenzimeve klimatike”. **Mungesa e hartimit të një pakete të tillë pamundëson monitorimin e përpjekjeve të kryera nga institucione të ndryshme dhe matjen e efektivitetit të këtyre ndërhyrjeve.** (VP.2)
- Marrja e financimit prej GCF dhe mbështetja nga buxheti i shtetit i projekteve të listuar, si veprime prioritare (kryesisht mbulimi i TVSH) ka plotësuar objektivin e vendosur në këtë veprim prioritar. Por fondi në dispozicion prej mbështetjes së huaj dhe financimeve të buxhetit vlerësohet i pamjaftueshëm për nevojat e vendit lidhur me përshtatjen. (VP. 3)
- **Nuk ka pasur asnjë zhvillim lidhur me ngritjen e sistemit të monitorimit për Planin Kombëtar të Përshtatjes.** Mungesa e një sistemi të tillë bën të pamundur vlerësimin e efektivitetit të masave dhe burimeve financiare të vendosura në dispozicion për secilën masë. Sistemi i monitorimit duhet të marrë në konsideratë jo vetëm progresin në masat zbutëse, por ecurinë e ndikimit të ndryshimeve klimatike në sektorë të ndryshëm. Këto të dhëna do të ndihmojnë në rishikimin periodik të veprimeve prioritare përshtatëse. (VP. 4)
- **Gjatë periudhës 2019-2021 ka pasur një numër fushatash informimi dhe ndërgjegjësimi të publikut,** të realizuara si pjesë e ndërhyrjeve për zbatimin e masave prioritare. Kryesisht ato janë ndërmarrë nga aktorë të shoqërisë civile. Mungesa e një baze të dhënash mbi këto veprime pamundëson vlerësimin sasior të ndërhyrjeve të tilla. Sidoqoftë, pranohet se ndërgjegjësimi publik është shtuar, i shprehur përmes pjesëmarrjes në rritje, shqetësimit publik të raportuar në media, etj. (VP.5)
- **Kapacitetet njerëzore që adresojnë çështjet e klimës mbeten shumë të kufizuara** dhe të pamundura për të mbuluar zhvillimet shumë dinamike të kuadrit ligjor Evropian për klimën, komunikimin ndërinstitucional ndërmjet institucioneve qendrore dhe agjencive të ndryshme. Kapacitetet në nivel vendor janë pothuajse tërësisht të mangëta. Numri i trajnimeve dhe kualifikimeve të realizuara ka qenë tërësisht nismë e institucioneve dhe programeve të huaja të mbështetjes, ku lëvizjet dhe ndryshimet në stafin teknik të institucioneve ulin efektivitetin e programeve të mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve. (VP. 6)

7. Grupi i dytë i masave (Veprime Prioritare 7-15) janë adresime sipas sektorëve të veçantë dhe për fusha specifike të ndërhyrjeve ku është vlerësuar se ndikimi i ndryshimeve klimatike është më i mprehtë dhe më i ndjeshëm.

- **Veprimet prioritare të lidhura, nën përgjegjësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, janë kryer pavarësisht fokusit të ndryshimeve klimatike dhe veprimeve përshtatëse për to. (VP.7).** Ecuria më e mirë e masave lidhur me menaxhimin e integruar të burimeve ujore ka të bëjë vetëm me hartimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujëmbledhës, ndërkohë që zbatimi i tyre në nivel vendor mbetet një sfidë e vërtetë për institucionet e qeverisjes vendore. (VP.8)
- **Veprimet prioritare të lidhura, nën përgjegjësinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit paraqesin një ecuri më të dallueshme sesa veprimet e tjera, për shkak të mbështetjes prej financimeve të huaja.** Ndër to, zbatim të plotë ka pasur veprimi prioritar 15 për masat përshtatëse në Kune - Vain, i cili ka krijuar mundësi zhvillimi projektesh të ngjashme edhe në zona të tjera me rëndësi natyrore. Por ecuri të vogël kanë pasur veprimtaritë lidhur me përshtatjen në turizëm dhe në zonën bregdetare. Mungesa e një Master Plani për këtë zonë, ka pamundësuar edhe përfshirjen e komponentëve të përshtatjes në të.
- **Veprimtaritë prioritare të zbatuara pjesërisht kanë qenë ato të lidhura me sektorin e shëndetësisë,** kryesisht të parandalimit të ndikimit të valëve të të nxehtit (VP. 10) dhe emergjencave civile (VP. 14) ku ngritja e kapaciteteve teknike për paralajmërimin e hershëm ka minimizuar humbjet e jetëve të njerëzve dhe zvogëluar dëmet ekonomike. Ngritja e Agjencisë së Mbrojtjes Civile ka ndihmuar në adresimin e problematikave vendore dhe reagimin e menjëhershëm, por kapacitetet e vendit mbeten shumë të kufizuara.
- **Veprimet prioritare për adresimin e përshtatjes në nivel vendor mbeten pothuajse tërësisht të papërmbyshura.** Kapacitetet vendore janë shumë të kufizuara dhe njohuritë rreth veprimeve përshtatëse janë të mangëta dhe të pa mbështetura me vlerësime e studime teknike për nevojat specifike të zonave të caktuara.

VI. ZBATUESHMËRIA E VEPRIMEVE PRIORITARE (VP), NË METRIKËN E NGJYRAVE

1: Drejtimi i procesit të përshtatjes në Shqipëri	
2: Krijimi i një pakete instrumentesh për integrim përshtatës ndaj Ndryshimeve Klimatike	
3: Gatishmëria financiare për Klimën	
4: Ngritja e një sistemi monitorimi për Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP)	
5: Nisma për informim dhe përfshirje të publikut	
6: Nisma për ngritjen e kapaciteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	
7: Ujitje, kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet	
8: Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore	
9: Përshtatja në sektorin bujqësor	
10: Nxitja e zbatimit të strategjisë së përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e shëndetësisë	
11: Plan i integruar ndërsektorial për zonën e bregdetit	
12: Nisma për krijimin e planeve të përshtatjes në nivel bashkie	
13: Përshtatja në turizëm	
14: Rritja e nivelit të gatishmërisë së mbrojtjes civile dhe zvogëlimit të riskut të fatkeqësive natyrore	
15: Rikuperimi i Lagunës Kune-Vain	

Aneksi 1: Lista e Institucioneve të Monitoruara

Agjencia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Agjencia e Efiçencës së Energjisë

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Këshilli Kombëtar i Digave të Mëdha

Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore

Zyra e Administrimit të Baseneve Ujore

VII. BURIMET

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, AKPT.

http://planifikimi.gov.al/index.php?id=akpt_about

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, AZHBR: Agjencia IPARD. Skema Kombëtare

2020. Website: <http://www.azhbr.gov.al/skema-kombetare/>

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, AZHBR: Programi IPARD II 2014 - 2020, thirrja IV,

website: <http://www.azhbr.gov.al/>

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, AZHBR: Programi IPARD II 2014 - 2020, thirrja II,

website: <http://www.azhbr.gov.al/thirrja-2/>

CNVP, Embassy of Sweden, Magnum Opus Group (2018): Dokument "Mbi politikat e sektorit të pyjeve në Shqipëri". <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/DPP-17.12.2018.pdf>

Development of Albania' Fourth National Communication to the UNFCCC and First Biennial Report. <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/projects/development-of-albania-fourth-national-communication-to-the-unfc.html>

European Union, EU (2018) : Guidance on the requirements for hydropower in relation to EU Nature legislation. Website:

https://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/management/docs/hydro_final_june_2018_en.pdf

GIZ: Guidance on applying the Stocktaking for National Adaptation Planning (SNAP) tool. Eschborn, 2014.

Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO). Website:

<https://www.geo.edu.al/newweb/?fq=brenda&gj=gj1&kid=42>

Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve (IRGJB): Njësi kryesore e Universitetit Bujqësor të Tiranës, UBT. Website: <http://qrgj.org/>

Instituti i Shëndetit Publik, ISHP: Zoonozat dhe Sëmundjet që Transmetohen nga Vektorët.

Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive. Website:

<http://www.ishp.gov.al/departamenti-i-kontrollit-te-semundjeve-infektive/zoonozat-dhe-semundjet-qe-transmetohen-nga-vektoret/>

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) ALBCOLD website <https://albcold.gov.al/>

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, KKDM (2020): Raport Vjetor për 'Gjendjen, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave dhe dambave në Shqipëri'. Website:

<http://albcold.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/1-Raporti-vjetor-2020-per-digat-dhe-dambat.pdf>

Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar (KKP), 2016.

Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar, (KKP) i rishikuar për Shqipërinë, 2021. Tabelat 19-25, faqe. 70.

Kune-Vain website: www.kunevain.com

Media fjala.al: Prezantohet Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Këshilli Teknik, flet

Balluku. Website: <https://fjala.al/2020/09/22/prezantohet-komiteti-kombetar-i-digave-te-medha-dhe-keshilli-teknik-flet-balluku/>

Ministria e Mbrojtjes: Strukturat vartëse të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC).

Website: <https://www.mod.gov.al/index.php/ministria/strukturat-vartese/akmc>

Monitoring the Climate Change Strategy in Albania, WFD, 2022, <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/monitoring-climate-change-strategy-albania>

National Adaptation Plan for Albania, <https://www.plan-adapt.org/projects/albania/#:~:text=How%20to%20Finance%20Climate%20Change%20Action%20in%20a%20Country%20That%20is%20at%20the%20Doorstep%20of%20the%20European%20Union>

Përkufizim i fitoplanktonit, wikipedia: <https://de.wikipedia.org/wiki/Phytoplankton>

Përkufizim i zoonozave, wikipedia: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/zoonoses>

Përkufizim i zooplanktonit, wikipedia: <https://en.wikipedia.org/wiki/Zooplankton>

Planet e Gadishmërisë në raste të Emergjencave Civile (PGEC) dhe Hartat e Përmbajtjeve.

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) ALBCOLD website:

<https://albcold.gov.al/pgec-dhe-hartat-e-permbytyjeve/>

Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, AKPT. http://planifikimi.gov.al/index.php?id=pins_bregdeti

Plani i Përgjithshëm Kombëtar: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, AKPT.

http://planifikimi.gov.al/index.php?id=ppk_shqiperia

Plani Kombëtar për Përshtatjen (PKP) ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri. Kuadri për Procesin e Vendit, Qershor 2016

Readiness and Preparatory Support Proposal (2019). Green Climate Fund.

<https://www.greenclimate.fund/sites/default/files/document/readiness-proposals-albania-undp-adaptation-planning.pdf>

Third National Communication to the United Nations Framework Convention on Climate Change 2016,

https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/environment_energy/third-national-communication-to-the-united-nations-framework-con/

United Nations for Climate Change (UNCCC).

https://unfccc.int/sites/default/files/resource/parisagreement_publication.pdf

VKM 849, dt. 04.11.2020 për miratimin e Planit të Menaxhimit të basenit ujor Drin–Bunë

<http://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/3.-Kontributi-Komb%C3%ABtar-i-Percaktuar-KKP-i-rishikuar-p%C3%ABr-Shqip%C3%ABrin%C3%AB-1.pdf>

Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është organ publik i Mbretërisë së Bashkuar i dedikuar për të mbështetur demokracinë në mbarë botën. Duke vepruar ndërkombëtarisht, WFD punon me parlamentet, partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile, si dhe me zgjedhjet për të ndihmuar shtetet të kenë sisteme politike më të drejta, më gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.



www.wfd.org



[@WFD_Democracy](https://twitter.com/WFD_Democracy)



[@WestminsterFoundation](https://www.facebook.com/WestminsterFoundation)



WFD

Fondacioni Westminster për Demokraci
është një organ ekzekutiv publik i sponsorizuar
nga Ministria e Punëve të Jashtme,
Komonuelthit dhe Zhvillimit.



UK Government